



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 2 NËNTOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
2. NOVEMBRA 2010. GODINE**

**NËNTOR – NOVEMBAR
2010**

E martë, 2 nëntor 2010, ora 13:00

Drejton seancën: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Kosovës.

Konstatoj se në sallë pranishëm janë të 99 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj që në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Procedojmë sipas rendit të ditës.

Në rend të ditës kemi vetëm një pikë:

**- Shqyrtimi i Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, i Grupit
Parlamentar të AKR-së, në mbështetje të 40 deputetëve**

Grupi Parlamentar i AKR-së dhe grupi i deputetëve, nënshkrues, në pajtim me nenin 100, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenin 30, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar Mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AKR-së, zotin Ibrahim Makolli, që në emër të deputetëve, nënshkrues, dhe në cilësinë e propozuesit ta paraqesë arsyetimin e Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

IBRAHIM MAKOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër i gjysmë Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Të respektuar kolegë,

Vendi sot gjendet në krizën më të thellë institucionale, që nga krijimi i institucioneve në vitin 2000. Kjo krizë e ka bazën në keqqeverisjen e vendit nga ana tash ish dy partnerëve të koalicionit, të cilët mbi interesin e vendit e kanë vënë interesin personal dhe partiak. Për shumë kënd kjo qeverisje do të mbetet në mend për të keq, ndërkaq dëmet që i janë shkaktuar vendit, do të kenë pasojë afatgjatë. Duke e ndjerë përgjegjësinë për zhvillimet e fundit dhe duke e parë mungesën e vullnetit politik të të dy partive në koalicion për zgjidhje të kësaj krize, Grupi Parlamentar i AKR-së, i mbështetur nga 40 deputetë të Kuvendit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 100, paragrafi 1 dhe në mbështetje të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 30, paragrafi 1, ka parashtruar Mocion mosbesimi ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Kriza institucionale, e shkaktuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ku ka konstatuar shkelje serioze të Kushtetutës nga ana e presidentit, që ka rezultuar me dorëheqje të presidentit të Republikës së Kosovës dhe pas tërheqjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës nga koalicioni qeveritar, rrezikon të derivojë me krizë të përgjithshme institucionale në vend.

Për dalje nga kjo krizë, Grupi Parlamentar i AKR-së, i mbështetur nga 40 deputetë, ngrit Mocion për mosbesim ndaj Qeverisë dhe kërkon nga Kuvendi ndërmarrjen e veprimeve të tjera në pajtim me Kushtetutën.

Kolegë të nderuar,

Qytetari i Kosovës sot i ka drejtuar sytë nga ky tempull, i cili e ka në dorën e vet nëse do të ndalojë keqqeverisjen dhe degradimin e mëtejshëm të institucioneve të vendit ose do të lejojë që edhe më tej të thellohet kjo krizë.

Të nderuar kolegë,

Ju ftoj që ta mbështesni këtë mocion, si e vetmja mënyrë për të dalë nga kjo krizë institucionale që ka përfshirë vendin dhe për ta dënuar këtë qeverisje të keqe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar i Parlamentit dhe ushtrues i detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra, kabinet qeveritar,

Të nderuar e të respektuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Sot jemi mbledhur përsëri këtu në Parlamentin e Kosovës, ne, të zgjedhurit e popullit të Kosovës, për një moment tjetër të veçantë.

Të nderuar deputetë, po e quaj moment të veçantë, sepse ky është edhe një test tjetër i rëndësishëm për shtetin tonë të ri.

Shteti ynë ka disa javë që është zhytur në një krizë politike dhe institucionale, por po përballemi me test të demokracisë në shtetin tonë të ri.

Këtë sfidë nuk mund ta anashkalojmë më tutje dhe duhet të jemi shumë të përgjegjshëm, prandaj është e domosdoshme që të përballemi më të dhe ta tejkalojmë bashkërisht, shpejt.

Të gjithë në këtë Parlament jemi betuar se do ta respektojmë Kushtetutën.

Të gjithë ne jemi zotuar se do ta vëmë interesin shtetëror para interesave partiake apo politike.

Sot, të gjithë ne, jemi të thirrur ta vëmë në praktikë betimin që e kemi dhënë.

Vota juaj sot, të nderuar deputetë, është vendim i ri për shtetin e Kosovës, për ta vërtetuar përkushtimin tonë për demokraci dhe liri. Vendimi juaj sot do ta forcojë dhe konsolidojë edhe më shumë shtetin tonë dhe demokracinë.

Demokracia dhe liria janë vlerat më shenjta për të cilat kemi luftuar aq shumë dhe të cilat janë paguar me sakrificën e të gjithë atyre që kanë ëndërruar për një Kosovë të lirë dhe të pavarur, pra sakrificën e gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në kujtim të gjithë atyre që dhanë aq shumë për ne dhe për hir të një të ardhmeje më të mirë për qytetarët tanë, ka ardhur koha që të gjithë ne ta vëmë interesin e Kosovës në rend të parë.

Të nderuar deputetë,

Sot besoj se do të veproni drejt duke i dhënë fund krizës institucionale dhe politike, e pastaj të dilni para qytetarëve në zgjedhje të reja për të rimarr besimin e tyre.

Duke bërë një veprim të tillë, i cili është plotësisht në përputhje me Kushtetutën tonë, ju i hapni rrugë krijimit të institucioneve të reja më të fuqishme të shtetit tonë, me një legjitimitet të ri.

Vota e sotme është një ndër ato votat më të rëndësishme, të nderuar deputetë, që ju keni pasur nderin të jepni në këtë Parlament.

Ndoshta tingëllon paksa edhe ironike, mirëpo vota e juaj sot do të jehojë për gjenerata të tëra dhe do të riafirmojë zotimin tonë për demokraci dhe liri.

Ne duhet t'i përmbushim obligimet tona para qytetarëve të cilëve duhet t'u shërbejmë me nder dhe devotshmëri.

Duhet të jemi të përgjegjshëm edhe ndaj botës demokratike, e cila na shikon për të parë se a jemi të denjë të jemi shtet ligjor, i cili respekton Kushtetutën, ligjet dhe vullnetin e qytetarëve të cilët i përfaqësojmë.

Duke vepruar kështu, të nderuar deputetë, ne do të dalim në ballë të krizës, do t'ua kthejmë stabilitetin institucioneve tona dhe do t'i kthehemi punës sonë në interes dhe në emër të të gjithë qytetarëve tanë.

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni të jem shumë i qartë. Qeveria që drejtoj unë, nuk e deshi dhe nuk e solli këtë krizë. Diçka të tillë nuk deshën as qytetarët e Kosovës, diçka të tillë nuk e merituan as qytetarët e Republikës së Kosovës, pra. Diçka të tillë nuk e deshën dhe nuk e pritën as miqtë ndërkombëtarë, por të gjithë sot duhet të veprojmë bashkërisht me vullnetin dhe vendimin tonë për ecje përpara.

Ne ishim në vllug të punës për të ndërtuar një Kosovë më krenare, më të fuqishme dhe më të mirë, më të zhvilluar.

Mirëpo, fatkeqësisht, kriza aktuale na u imponua dhe duhet të përballemi me te, krizë kjo që ngadalësoi progresin që kishim filluar.

Unë jam krenar me rrugën të cilën e kishim nisur, të cilën e ndërtuam dhe të cilën duhet ta finalizojmë përsëri bashkërisht.

Jam krenar me arritjet tona për këto tri vjet të qeverisjes.

Gjatë kësaj periudhe, ne arritëm ta vëmë Kosovën, në rend të parë, duke u ofruar fëmijëve tanë shkollim, të cilin vetëm mund ta kemi ëndërruar më parë.

E bëmë këtë duke ndërtuar shkolla të reja, hapësira të reja moderne dhe duke u dhënë libra shkollor falas.

Kemi ndërtuar rrugë të reja në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar, kemi përmirësuar infrastrukturën tonë duke i bashkuar të gjithë kosovarët dhe duke e forcuar biznesin dhe zhvillimin ekonomik. Kemi bërë shumë gjera të mira dhe shumë të tjera janë në proces.

Më këtë rast, dua t'i falënderoj, të nderuar deputetë, të nderuar të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës për mbështetjen, por edhe për kritikën që i keni drejtuar në adresë të Qeverisë time, personale dhe dëshiroj ta falënderoj secilin prej juve veç e veç edhe personalisht edhe për mbështetje, edhe për debatet, edhe për kritikën tuaj kur i keni adresuar me qëllimin më të mirë, për një punë edhe më të mirë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Dhe, vetëm ashtu, ne mund të ndërtojmë demokracinë sot dhe në të ardhmen.

Gjithashtu, të nderuar deputetë, përfitoj nga rasti t'i falënderoj partnerët e koalicionit të deritanishëm për punën e përbashkët, gjithë ministrat që janë këtu ulur të Partisë Demokratike të Kosovës, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të komunitetit serb, të komuniteteve jo serbe, të përfaqësimit nga shoqëria civile. Kam pasur nderin dhe kënaqësinë të punoj me të gjithë dhe ruaj respektin më të madh për punën e përbashkët që kemi bërë nga momenti i themelimit të Qeverisë, shpalljes së pavarësisë, konsolidimit dhe forcimit të shtetit tonë dhe tash, në këtë kapitull të ri që po hapim bashkërisht.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Tani më lejoni që t'i siguroj qytetarët tanë të nderuar, duke thënë se edhe gjatë javëve në vazhdim Qeveria do të vazhdojë t'i kryejë obligimet e veta kushtetuese dhe ligjore me kapacitetet e saj aktuale.

Përkundër rrethanave të reja, ne nuk do të ndalemi t'iu shërbejmë dhe t'i kryejmë obligimet tona në përmbushjen e nevojave tuaja, qytetarë të dashur.

Ne do të vazhdojmë t'u ofrojmë fëmijëve tanë shkollimin e tyre, rrugët do të vazhdojnë të ndërtohen, ambulancat dhe spitalet do të vazhdojnë punën, mësimdhënësit, punëtorët shëndetësorë, policët, shërbyesit civilë, pensionistët, veteranët do të vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre.

Një falënderim të veçantë, më lejoni t'ju dërgoj të gjithë shërbyesve civilë, me të cilët kemi pasur fatin, kënaqësinë të punojmë dhe për shërbimin e tyre të mrekullueshëm që e kanë bërë në emër dhe në shërbim të institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë trivjeçare.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar, të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë edhe më tutje do të vazhdoj që mbi çdo interes tjetër, të vë së pari Kosovën.

Ka qenë dhe vazhdon të jetë nder për mua që t'ju shërbej qytetarëve të Kosovës, si kryeministër. Së bashku kemi kaluar nëpër shumëçka dhe kemi arritur shumëçka.

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë partnerët ndërkombëtarë: KFOR-in, EULEX-in, ICO-n, vendet e Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen dhe partneritetin e ngushtë që kanë treguar në mbështetje të shpalljes së pavarësisë, të konsolidimit të shtetit tonë, të njohjeve të reja dhe perspektivës euroatlantike.

Ne kemi një objektiv, e ai objektiv është i përbashkët, pra, forcimi i shtetit tonë, zhvillimi i shtetit tonë, mirëqenia sociale e qytetarëve tanë dhe integrimi sa më i shpejtë i Kosovës në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Gjatë tërë jetës sime, unë njësoj, sikur shumica e qytetarëve të Kosovës, kam ëndërruar dhe punuar për tri gjëra.

E para, ishte çlirimi i Kosovës;
E dyta, Kosova e pavarur, e lirë dhe unike;
E treta, është integrimi i Kosovës në NATO dhe Bashkimin Evropian.

Do të vazhdojmë që të punojmë për qeverisje të mirë, për një qeverisje edhe më të fortë, për integrim të Kosovës në strukturat euroatlantike, pra do të jetë detyrë primare e Qeverisë së ardhshme të Republikës së Kosovës, që do të dalë nga vota dhe legjitimiteti i ri, qytetarë të Kosovës.

Kosova evropiane, ka qenë, është dhe do të jetë përcaktim dhe vizion ynë, sepse ajo nënkupton hapje të perspektivës për të ardhmen dhe vende të reja të punës për qytetarët tanë, nënkupton progres.

Të bashkuar ne mund të bëjmë këtë vizion realitet dhe unë kam besim të plotë në angazhimet tona të përbashkëta, në energji të reja dhe vizionin tonë shtet ndërtues.

Natyrisht, edhe në të ardhmen do të kemi qeveri dhe do të kemi edhe parti opozitare, por të gjithë, siç kemi punuar edhe në këto tri vjet, do të punojmë për konsolidimin dhe forcimin e shtetit tonë, sepse jam i bindur se vetëm të bashkuar mund të vëmë Kosovën në rend të parë, mund të ndërtojmë Kosovën demokratike dhe multietnike.

Sot, Kosova përballlet me krizë institucionale dhe politike, por së bashku mund t'i tregojmë botës se sa të fortë dhe të bashkuar jemi, ne, politika e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës, pa dallime partiake, pa dallime etnike apo religjioze.

Ndërsa, e nesërmja do të jetë një rast tjetër i mirë për të vazhduar së ndërtuari rrugën e Kosovës drejt një të ardhmeje më të mirë për të gjithë qytetarët e saj, pra, së pari Kosova.

Dëshiroj t'ju falënderoj në emrin tim personal, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjithë juve, deputetë të nderuar, për mbështetjen që keni treguar, dëshiroj t'ju falënderoj të gjithë qytetarët e vendit për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre që kanë treguar në angazhimet tona dhe dëshiroj t'ju falënderoj të gjithë miqtë ndërkombëtarë për mbështetjen e tyre.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Po fillojmë sipas radhës.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar, të dashur dhe të respektuar kolegë deputetë,

Ju përshëndes të gjithëve!

Dhe, në fjalën time krejt të nismës, po ju them që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka vendosur që ta votojë Mocionin për mosbesimin Qeverisë. Dhe, kjo çështje është shumë e qartë dhe krejtësisht e shpjegueshme për arsyet që qëndrojnë fuqishëm.

E respektoj shumë zotin kryeministër, kryetarin e partisë, kam respektuar dhe e respektoj më gjithsesi edhe Qeverinë aktuale, në atë pjesën serioze të veprimit të saj serioz, shumë të suksesshëm, shumë përmbajtjesor, por me siguri që duam, çmojmë dhe respektojmë më shumë Kosovën dhe nuk duam që Kosovën ta lëmë në gjendjen çfarë është, në krizën që e ka kapluar dhe nuk duam t'ia trashim akoma më shumë këtë krizë, por duam ta shkurtojmë dhe të shkojmë në një adresë që ne e dimë mirë se ku jemi nisur dhe cili është caku ynë.

Ne dimë po kështu se janë dy momente që e krijuan krizën, jo as kryeministri, as Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, por janë dy momente që i dimë të gjithë, por dua t'i përsërisim, vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe ikja pa mbulesë as juridike, as politike, as tjetër e kolegëve tanë të koalicionit nga Qeveria.

Kjo krizë do përgjigje të shpejtë, logjike, përmbajtjesore dhe krejtësisht praktike. Askush nga ne të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nuk e ka dëshiruar ndërprerjen e mandatit. Ne kemi dashur dhe kemi synuar që mandatin ta çojmë deri në fund, sepse kjo do ishte gjëja më logjike, por e bëjmë sot një veprim që mbase mua më duket i pazakonshëm, në fakt është i zakonshëm, krejtësisht i pjekur politikisht dhe plotësisht i arsyetueshëm praktikisht.

Andaj, hiq pa keqardhje, po me plotësi të mendimit, të qëndrimit, të veprimit racional, ne do japim votën "pro" mocionit.

Kjo Qeveri që ka pasur plot suksese, ka pasur plot sfida, ka realizuar shumëçka nga ajo pjesë që ka synuar, siç u tha nga kryeministri, por është një moment që ne do të duhej t'i themi që këtu është fundi dhe për të realizuar një fillim të ri, të mbarë, të suksesshëm dhe ne besojmë që ky fillim i mbarë do të jetë shumë edhe më i suksesshëm seç ishte gjer më tani.

Dua ta shfrytëzoj rastin ta përmend edhe një fjalë të urtë të profesorit të nderuar, që jo rastësisht i ka mbushur 90 vjet, një libër që tani e morëm: "Mos fol gojë, pa nevojë". Unë jam përpjekur, të nderuar dhe të dashur deputetë, që këtë foltore tonën të mos e përdor dhe të mos e keqpërdor asnjëherë. Asnjëherë s'i kam dhënë të drejtë gojës sime të flas pa nevojë. Sot këto fjalë që po ju them, janë fjalë më të sinqerta miqësore për ju. Unë ju them që për ta shkurtuar krizën që ka kapluar vendin, ju kërktoj që ta votoni këtë mocion të iniciuar nga AKR-ja, natyrisht të mbështetur nga shumica e deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fjalën e ka kryetari i Grupit të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurish që ngritja e një mocioni për votëbesim të Qeverisë është e drejtë kushtetuese dhe bazuar në nenin përkatës të Kushtetutës, por Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Grupi Parlamentar i LDK-së nuk pajtohet dhe nuk e pranon arsyetimin dhe as përmbajtjen e këtij mocioni. Pra, si

përmbajtje është e papranueshme dhe si të tillë ne nuk e përkrahim dhe nuk marrim pjesë në votim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nëse dikush kishte kërkuar prej nesh ta përmbledh fjalën e kryeministrit, mu duk që na tha:” Ju lutem, më shkarkoni se a e dini sa i mirë kam qenë”, domethënë edhe ishte shumë, shumë interesant.

Tash, po vazhdoj me dy pjesë të fjalës sime dhe në dy pjesë.

Së pari, do të ju tregoj pse Aleanca mendon se kjo Qeveri ka qenë dashur të shkojë kohë më parë, pse ne mendojmë se kjo Qeveri ka qenë dashur që, të paktën, para 2 vjet e gjysmë të japë dorëheqje ose të largohet.

Fillimisht, kjo Qeveri është dashur të shkojë në shtëpi për shkak se 3 vjet pas ardhjes në pushtet, 3 vjet pa një muaj ose dy, qytetari i Kosovës me rrogën e vet “të rritur” blen 28% më pak se sa ka blerë në nëntor të vitit 2007, s’janë shifrat e mia.

Kjo Qeveri duhet të shkojë se sot Kosova është në tapet si vendi më i korruptuar në rajon, prapë nuk janë fjalët e mia. Krahasonet me vendet e prapambetura diktatoriale të Afrikës, për të mos i përmendur, se ndoshta i fyej ato shtete.

Kjo Qeveri duhet të shkojë, se e ka cenuar lirinë e medieve, prapë nuk janë fjalët e mia.

Vendi ynë sot e jep pamjen e Ballkanit të viteve të 90-ta, e Ballkani i viteve të 90-ta ka qenë një regjion ku është sunduar prej partive në pushtet, ku është cenuar liria e mediave, ku janë manipuluar votat, kështu ka qenë Ballkani i viteve të 90-ta dhe Kosova ka mbetur i vetmi vend në Ballkan që sot e jep atë pamje, vend ku kërcënohet gjyqësori, ka qenë njëjtë, vend ku administrata publike është administratë e partisë, jo e shtetit, vend ku njerëzit që janë zgjedhur, abuzojnë skajshëm me votën, me paranë publike dhe me të gjitha të mirat tjera të përbashkëta dhe drejtësia nuk guxon të merret me ta, po guxon të merret me disa të tjerë që janë më të kollajshëm, vend ku demokracia dhe liria që i përmendi zoti kryeministër, janë vetëm fjalë, fraza boshe, të cilat fatkeqësisht shpesh përdoren edhe me cinizëm, po kurrë me seriozitet.

Kjo Qeveri duhet të shkojë, ka qenë dashur të shkojë më moti se e ka zbrazur arkën e shtetit dhe tash duhet t’i shesë ose synon, ka synuar t’i shesë ose të paktën po themi për kompaninë e vetme fitimprurëse në Kosovë.

Kjo Qeveri duhet të shkojë se pas 3 vjet qeverie, veriu i Kosovës është më i ndarë se kurrë më përpara.

Kjo Qeveri duhet të shkojë edhe për shkak të 6 - pikëshit.

Kjo Qeveri duhet të shkojë, në fund të fundit, se nuk e ka mbajtur asnjë premtim përmes të cilëve ka ardhur në pushtet, as për 24 orë rrymë, as për punësim më të madh, as për luftë kundër korrupsionit, as premtimin për integrimin e veriut nuk e ka mbajtur, as premtimin për ulje të kriminalitetit edhe krimin të organizuar e as 100 njohje deri në qershor të vitit 2008.

Kjo Qeveri duhet të shkojë se askush në këtë vend nuk është tashmë i lumtur, përpos njerëzve që janë në pushtet, familjarëve edhe klientëve të tyre, të tjerët janë të palumtur këtu në këtë vend për shkak të Qeverisë.

Tani disa fjalë për mocionin.

Aleanca mendon se kërkuesit e mocionit i kanë pasur një mori arsyesh që një gjë të tillë ta bëjnë shumë më përpara, shumë më herët. Pse nuk është kërkuar mocioni në vitin 2008, kur vetëm 2 muaj pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, ajo është shkelur, prapë nuk janë fjalët e mia, është shkelur përmes tenderit të lindjes. Këtë e ka thënë Komisioni Evropian, jo unë, nuk janë fjalët e mia, prapë.

Pse nuk është kërkuar mocioni para disa muajve, kur është shkelur Kushtetuta në Rahovec? Pse nuk është kërkuar mocioni kur është vjedhur policia dhe asnjë njeri nuk është mbajtur përgjegjës.

Pse nuk u kërkua mocion kur u nxorën 262 milionë euro jashtë vendit kundër ligjit. Po ju them diçka. Kur njerëzit e shkelin ligjin, e shkelin ligjin, por kur Qeveria e shkel ligjin, e thyen edhe Kushtetutën që duhet ta mbrojë, edhe atje u thye Kushtetuta. Kur institucionet ekzekutive e shkelin ligjin, në të njëjtin kohë e kanë shkelur edhe Kushtetutën, në parim.

Mund të them se kanë mund të kërkojnë edhe mocion votëbesimi kur është turpëruar Kosova prej Zanzibarit, kanë mund të kërkojnë mocion në 100 raste të tjera, por nuk e kanë kërkuar, edhe nuk e kanë kërkuar se në këtë legjislaturë nuk ka numra të mjaftueshëm për mocion nëse Partia Demokratike e Kosovës nuk voton, në këtë legjislaturë i ka do numra.

Tani, po ju them, ne nuk mendojmë se ky mocion mosbesimi është kërkuar për ta nxjerrë vendin nga kriza. Ky mocion është thirr për të mbajtur zgjedhje në terr, thotë në dhjetor, dhe pa Ramush Haradinajn, në Kosovë.

Ne për këtë dhe për shumë arsye tjera, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk merr pjesë në votim, do të thotë, nuk do të marrë pjesë në votim, përpos të gjitha arsyeve tjera edhe për t'i zbardhur të gjitha aleancat që kanë ekzistuar, të gjitha marrëveshjet që kanë ekzistuar që tri vjet e që nuk janë zbardhur.

Edhe në fund, krejt në fund, vetëm edhe disa fjalë.

Po ua përkujtoj një fjali timen prej kësaj foltore para dy vjetëve, në një mocion ju kam thënë, do të bien vetë. Ka dalë e vërtetë, po votojnë veten - jashtë Qeverisë. Po do t'ju them edhe një tjetër të vërtetë, e tjetra e vërtetë është se prej vitit 2007 deri në vitin 2009 jemi rritur dyfishë, do të rritemi edhe një herë dyfishë edhe do të rritemi për shkak se duhet ta nxjerrim vendin prej kësaj situatë dhe duhet t'ua kthejmë shpresën njerëzve që i ka sfilatur kjo Qeveri. Ju faleminderit shumë dhe sukses!

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti dhe kryetari i Partisë Aleanca Kosova e Re, Behgjet Pacolli.

BEHGJET PACOLLI: Prapë në këtë foltore, po më duket është hera e dytë prej kur jam deputetë i Kuvendit të Kosovës, atëherë kur e kam mbështetur fuqishëm këtë Qeveri, zoti kryeministër, dhe atëherë kur kam besuar se gjërat do të shkojnë si duhet.

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para 3 vjetëve kur dola në këtë foltore, isha tejte i gëzuar dhe i impresionuar nga arritjet e popullit tim, isha plot shpresë në rrugën që e priste shteti i ri i Kosovës. Ne të gjithë këtu, në një shumicë dërmuese votuam Qeverinë që do të drejtonte shtetin e Kosovës, shtetin e ri. Ne formuam për herë të parë shtet dhe është dashur të jemi unik, ashtu kam besuar.

Kjo Qeveri ishte e obliguar t'iu printe proceseve historike të vendit, si: organizimit të procesit për shpalljen e pavarësisë, përpilimit të Kushtetutës së vendit, miratimit të ligjeve për shtet bërjen e Kosovës dhe ajo që është me rëndësi, krijimit të kushteve për zhvillimin ekonomik të vendit dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kështu u zotua edhe kryeministri i zgjedhur nga vota e qytetarit, bile edhe ai dha edhe premtime tjera, shumë premtime. Atë kohë, unë dhe partia ime ishim optimistë për të ardhmen e shtetit të ri të Kosovës, ishim të gatshëm të kontribuojmë, ishim të gatshëm të bëjmë çdo gjë për hir të unitetit, për hir të shtet ndërtimit. Krejt bota ishte fokusuar tek ne.

Unë nga kjo foltore e mbështeta këtë Qeveri fuqishëm, por singerisht atëherë as që mendoja se ju nuk do t'i përmbushni premtimet tuaja, zoti kryeministër. Nuk mendoja se me mbështetjen time do të dëmtoja një ditë subjektin tim politik dhe ajo që është me rëndësi, ndoshta edhe do të dëmtoja qytetarin e Kosovës.

Të nderuar kolegë të Parlamentit të parë ose të këtij Parlamenti që shpalli pavarësinë e Kosovës, sidoqoftë unë kam respekt të madh për, ju zoti kryeministër dhe kolegët e mi parlamentar, me të cilët së bashku shpallëm pavarësinë e Kosovës. Ishim në gjendje të bëjmë çdo gjë, se për herë të parë formuam shtet, mos e harroni këtë. E gjithë bota, edhe një herë ju them, se shikonte në ne çka po bëjmë.

Besoja në unitet dhe isha i bindur se së bashku do të ndërtojmë shtet për qytetarin e Kosovës. Në atë kohë unë vija nga një lobim i fortë për pavarësinë e Kosovës dhe në mendjen time ekzistonte vetëm pavarësia, shteti për qytetarët e Kosovës dhe konstruktiviteti, në këtë konstruktivitet besoja edhe të gjitha partitë politike, gjegjësisht të spektri politik i Kosovës.

Unë besoja edhe te ju, të dashur kolegë, besoja se kjo ishte edhe dëshira e qytetarit e shprehur me votën e tij. Ne nuk na interesonte pushteti, por na interesonte një shtet modern dhe i mirëfilltë.

Formulat që u bënë dhe u formua një koalicion dhe nga kjo foltore unë thashë se kam frikë se ky koalicion është i panatyrshëm dhe i lejova vetes ta çoj bile edhe gishtin, kur i thashë kryeministrit se kam frikë, zoti kryeministër, se do të dështoni. Tani po i çoj prapë këtë gisht, duke thënë se kam pasur të drejtë, zoti kryeministër, ju keni dështuar me partnerin tuaj që e zgjodhët atëherë. Por, konstruktiviteti që pata unë, konstruktiviteti dhe shpirti im që unë kisha në veten time, ka qenë, është tani dhe do të jetë gjithmonë për qytetarin e Kosovës se, në fund të fundit, nuk më intereson pushteti. Unë kam ardhur në Kosovë për qytetarin e Kosovës, nëse mund t'i ndihmoj dhe t'i dal krah atij.

Zoti kryeministër,

Atëherë ju pata mbështetur edhe ju, besoni pa prapavija, pa paragjykime dhe pa favore, mbështetjen për qeverinë tuaj e konsideroja si obligim qytetar.

Premtimet e juaja që ju dhatë qytetarëve gjatë fushatës zgjedhore 2007, i përsëritët edhe në këtë foltore kur formuat Qeverinë. Nga kjo foltore po ashtu u thashë se nëse dështoni në premtimet dhe zotimet tuaja, unë do të jem kundër jush. Sot, zoti kryeministër, unë jam kundër jush. Akti i shpalljes së pavarësisë më impresionoi deri në atë masë, sa që harrova se dikush në këtë vend mund të shfrytëzojë këtë për interesa partiake, klanore e të tjera.

Tani u them se u vërtetua se koalicioni në mes jush ishte i panatyrshëm, zoti kryeministër, u thashë edhe atëherë. Nuk patëm rrymë 24 orë, mos harroni, nuk pati punësim, nuk patëm autostrada me gjashtë korsi, nuk e rritët buxhetin e Kosovës, si premtuat dy herë, në vitin e parë, nuk përmirësuar situatën e varfërisë, nuk patëm zhvillim ekonomik, ndodhi krejtësisht e kundërta. Dhe, sot ju them se ju nuk përmbushët premtimet tuaja, dështuat bashkë me partnerin tuaj që zgjodhët atëherë.

Edhe shtetin nuk e integruat, sovranitetin nuk e shtritë në tërë territorin e Kosovës, nuk përmirësuar cilësinë e arsimit dhe të shëndetësisë, nuk ngritët etikën dhe moralin e shoqërisë, munguan 100 njohjet e premtuara në 100 ditët e para. Sot, Kosova nuk është e sigurt, por këtu ndodhi krejtësisht e kundërta. Edhe kjo qeveri dështoi, ashtu siç dështuan krejt qeveritë e mbas luftës, mos harroni!

I nderuar, zoti kryeministër,

Do të jem tërësisht i sinqertë me ju, edhe ju keni dështuar, më vjen keq. Unë sot do të doja t'i numëroja të gjitha ato që bëtë për Kosovën, por ka kapluar e keqja, më vjen keq.

Unë dhe AKR-ja kemi ngritur zërin shumë herë kundër këtyre dukurive pasi që edhe Parlamenti i Kosovës, zoti kryetar i Parlamentit, nuk ka qenë gjithmonë vendimmarrës, ka pasur interferenca edhe në këtë parlament.

Ju edhe koalicioni juaj nuk u ndalët vetëm me dështimet e lartpërmendura, por vazhduat tutje, bashkë me partnerin tuaj në koalicion. Merrni me mend, qytetari i parë i këtij shteti të ri të brishtë, presidenti i Kosovës, ishte i pari që e shkeli Kushtetutën. Ajo çka është më keq, zoti kryeministër, ai thotë se e ka bërë atë në konkordancë të plotë me ju. Por, të kthehem edhe pak në retroskenë, edhe ju keni thyer Kushtetutën e Kosovës, në rastin e Rahovecit, mos harroni!

Ishte fati ynë që ndikimi juaj nuk mbërrini te Gjykata Kushtetuese dhe ajo veproi drejt.

Ministrat tuaj braktisën detyrën, dezertuat zotëri, dezertuat, vendet tuaja dhe e latë qytetarin, siç e tha kryeministri njëherë, e lat shkret, e lat pa kujdes. Qytetari mbeti pa shërbimet e tij, qytetari humbi çdo kontroll mbi institucionet e veta, e hutuat qytetarin këtu. Që është më e keqja, kjo Qeveri tentoi ta drejtojë shtetin në mënyrë një partiake, vendi gjendet kështu në një krizë të paparë ndonjëherë, pa 6 ministra, zoti kryeministër.

Ushtruesi i detyrës i lejon vetes që të firmosë brenda një dite mbi 140 gjyqtarë, një pjesë e të cilëve janë preferenca personale të partisë tuaj, gjegjësisht të tij.

Kriza rrezikon buxhetin e Kosovës, rrogat e arsimtarëve, të policëve dhe të zyrtarëve tjerë, zoti kryeministër.

Të nderuar deputetë,

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Regjia, edhe dy minuta, deputetit Pacolli!

BEHGJET PACOLLI: Ne pritëm dy javë që kryeministri të jepte dorëheqje apo të plotësonte Qeverinë sipas Kushtetutës. Kjo nuk ndodhi. Unë dhe subjekti im politik e pamë të arsyeshme që këtë problem ta kthejmë nga kuluarët, nga rrugët, nga kafet këtu në parlament, aty ku e ka vendin.

Organizuaam një tryezë të partive opozitare, me sinqeritet, kolegë të mi, dhe aty morën pjesë disa, bile edhe partitë joparlamentare, por disa nuk morën pjesë. Ne i falënderojmë 40 deputetët, firmatarë të mocionit për të rrëzuar këtë Qeveri. Kjo gjendje ishte e padurueshme dhe nuk priste më. Dikush ndjeu tek ky mocion mosbesimin që e nisi AKR-ja, një pasiguri dhe e kritikuan këtë. Besomëni se unë në atë tryezë u thirra juve që ta diskutojmë këtë tekst, ju nuk erdhët. Prandaj, nuk keni të drejtë ta përfllisni atë tekst. Në këtë moment është për mua e parëndësishme kush çka thotë, ne jemi në anën e qytetarit, e qytetari do qartësi. Ne e dimë që kjo Qeveri, de fakto ka rënë, por kudo në botë, në botën moderne qeveritë rrezikohen ose rrëzohen me procedura. Ne e bëmë këtë me procedurën e Kuvendit të Kosovës. I falënderojmë të gjithë deputetët nënshkrues të këtij mocioni. Tani kërkojmë nga të gjithë ju që të votoni këtë mocion, është e drejtë, qytetari e pret këtë akt sot dhe ju falënderoj të gjithëve! Nënshkruani këtë! Në gjithë botën opozita është kundër Qeverisë, prandaj tregohuni opozitë e vërtetë dhe kritikati e juaja që i bëni sot, të nderuar kolegë opozitarë për mocionin, por pse ju nuk...

(ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Vazhdojmë debatin. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli, e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Për tri vite të kësaj qeverisjeje të koalicionit PDK – LDK, Kosova ka marrë vetëm vlerësime negative nga raportet ndërkombëtare. Për çdo vit, të nderuar deputetë, Kosova është cilësuar njollë e zezë dhe këtë mjaftë qartë e kanë cilësuar institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë më prestigjioz, duke filluar nga raportet periodike të Departamentit Amerikan të Shtetit, raportet periodike të progresit të Komisionit Evropian, të Bankës Botërore dhe kështu me radhë.

LDD vlerëson se për këto tri vite të qeverisjes të koalicionit PDK-LDK, në Kosovë është ngulitur thellë krimi i organizuar, korrupsioni dhe të gjitha llojet e trafikëve.

Të nderuar deputetë,

Sot Kosova, me gjithë resurset e saja, identifikohet vend i varfërisë. Ngritje e vazhdueshme shkallës së papunësisë dhe varfërisë ekstreme, një ekonomi para kollabimit, shëndetësi jashtë normave të pranueshme ndërkombëtare, janë produkte të kësaj politike sterile që e kanë ngulitur partnerët e koalicionit PDK-LDK dhe kjo politikë sterile duhet të përfundojë një herë e përgjithmonë.

Të nderuar deputetë,

Po sublinoj fare thjeshtë. LDD do të votoj që kjo qeverisje të shkojë një orë e më parë, duke e cilësuar si mënyrë e vetme për të hapur rrugë për alternativë të re, që qytetarët e Kosovës e presin sot. Ne përkrahim mocionin dhe do të votojmë pro këtij mocioni, si zgjidhje e vetme që ofrohet alternativë dhe ofrohet prosperitet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Gospodine predsedniče,

Vršioce dužnosti predsednika Kosova,

Gospodine premijeru,

Zameniće premijera,

Ministri,

Kolege,

Evo, danas je prilika, makar i pre vremena, da pomalo sumiramo šta smo postigli, a šta propustili. Ja istinski zahvaljujem prvo vršiocu dužnosti predsednika u svojstvu predsednika Skupštine, da smo imali dosta uspeha, ja bih rekao u institucionalnom zaživljavanju multietničnosti i multijezičnosti.

Kada je u pitanju parlamentarna grupa, čiji sam šef, dakle „7+“, imali smo, ja se nadam bili smo korektni koalicioni partner. Govorim u ime zajednica koje predstavljam u Parlamentarnoj grupi, mislim da smo u ovim istorijskim vremenima, kada je naša država ispisivala prve stranice svog postojanja, mi smo bili deo tih stranica, mi smo bili deo tog uspeha i nimalo manje, dakle, sa naše strane nije pružena volja i želja da se integrišemo u svoju državu.

Ova vlada nije doživela četvorogodišnji redovni mandat, ali u svakom slučaju, za tri godine rada ja mogu da nabrojim ovde jednu po dužu listu i uspeha koje smo postigli, ali i propusta kojih je bilo. U uspehe neću nabrojati ono što sam već pomenuo, dakle zaživljavanje i stvaranje našeg realnog mesta u ovom društvu, i ako smo u tako malom broju zastupljeni. Međutim, ja bih rekao da kada su u pitanju neuspesi, ima onih koji su objektivne prirode i onih koji su subjektivne. Među propuste koje smo imali u ovom mandatu, ja smatram da smo malo kasnili sa decentralizacijom u sredinama gde živimo i da je ovaj već zajednički propust, odlazak mladih i kreativnih ljudi nije prestao i tu su objektivne, sigurno i svakako subjektivne poteškoće. Međutim, ja bih rekao, poštovani premijeru, da ste kao čovek koji je bio na čelu vlade, bili toliko puta podržani od nas da ostanete na ovoj vladi, međutim ako je procena velikih partija, procena najveće partije, da bi vanredni izbori bili pokušaj sprečavanja stvaranja institucionalnog vakuma ili krize, mi smo prihvatili te vaše razloge, iako smo i u razgovorima sa vršiocem dužnosti predsednika, prvo kada smo dogovarali prevremene izbore, naveli čitav niz razloga zašto nam oni ne odgovaraju, od onoga da izbori zimi ne motivišu građane, do onoga da naši birači uglavnom žive, ja bih rekao u planinskim predelima, gde je teško ostvariti tu građansku dužnost, do onoga da nam se jedna godina rezervisanih mesta predviđenih i Ahtisarijevim dokumentom i Ustavom Kosova skraćuju.

Međutim, Vi ste prihvatili te razloge i rekli da ćemo možda pokušati da nađemo nadoknadu toga što gubimo. Ako smo vas, kažem, toliko pluta podržali, ovoga puta ćemo vas podržati i da padnete. Hvala vam!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të grupit parlamentar SLS, fjalën e ka deputeti Slllobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsedniče,

Poštovani premijeru,

Zamenice premijera, ministri,

Koleginice i kolege narodni poslanici,

Uvaženi gosti,

Građani Kosova,

Ja ću pričati tiše i jasnije kako bi me razumeli i oni koji gledaju ovaj prenos sa velikim interesovanjem.

Dozvolite mi da se na početku, pre svega zahvalim svima onima koji su zajedno sa nama uspeli da Srpskoj zajednici bar vrate nadu u jedno bolje sutra. To nije bilo lako ni za nas, a to nije bilo lako ni za naše kolege ovde.

Gospodine premijeru, ja se vama zahvaljujem, zamenici ministra, ministri koji sede iza mojih leđa i ministri koji sede ispred mene. Zahvaljujem se i vama uvažene kolege i koleginice, narodni poslanici. Mi smo prošli jedan put koji je bio jako trnovit od tri godine. I ako smo najmlađi poslanici ovde u Parlamentu, trudili smo se da budemo najodgovorniji upravo zbog onih ljudi koji su dali poverenje da budemo u ovom visokom domu, tako ćemo i time da se vodimo i danas.

Ovo prevazilazi stranačko pitanje, ovo prevazilazi lično pitanje i mi kao odgovorni ljudi, moramo odgovorno da se ponašamo. Ja ću možda biti maslo sebičan. Dozvolite mi da se zahvalim pre svega ministrima koji su u Vladi ispred naše stranke, koji su dali veliki značaj, veliki doprinos Poslaničkom klubu koji broji 8. člana, gde su pripadnici i drugih zajednica, ne samo srpske i to je jedan kvalitet koji je nama garant za bolje sutra.

Ne bih želeo da tražim mane, jer ako tražimo mane, ostaćemo dugo. Mnogo je lakše kritikovati, nego nešto uraditi. I ovo stanje za nas jeste jedno normalno stanje demokratije. Nije čudo. Znači, ovo je još jedna potvrda ove vlade da se poštuje demokratija, i to je interes, to je ohrabrenje za sve građane Kosova, bez obzira što smo mi kao politička stranka deo ove vlade. I ako bi gledali taj viši interes, onda bi bili sebični i rekli bi da ova vlada ostane, ali mi hoćemo da potvrdimo sva ova naša angažovanja koja su bila do sada i ovim putem. Znači, ne želimo da nikog delimo na onu ili ovu stranku, mi smo partneri sa građanima Kosova. Želimo svakom građaninu Kosova dobro, pa i u regionu. Sigurno, kao predsednik Srpske zajednice, ja sam odgovoran pre svega da artikulišem probleme koje ima moja zajednica, i ja te probleme neću moći da rešim bez vaše podrške. Zato koristim priliku da se zahvalim i našim prijateljima iz međunarodne zajednice, kako iz Evropske unije, tako i ICO, i posebno Sjedinim Američkim Državama, koje su uspele i koje su pre svega verovala u nas da ćemo zajednički da prođemo ovaj put, a najbolje potvrda da smo svi zajedno dobili, jeste da je taj i da su srpski glasači 10 puta u većem broju izašli na poslednjim izborima, znači ljudi su videli neku svoju šansu.

Vi znate da smo mi stranka rešenja, a ne stranka problema. Mi želimo da iz ovog problema izađemo zajedno i zato vas molim da kao odgovorni ljudi, tako to i shvatite. Ovo nije niti za nekoga, niti protiv nekoga, ovo je u interesu građana. Ja kao odgovaran čovek i predstavnik ovih odgovornih ljudi koji su iz moje stranke u ovom visokom domu, kažem da ćemo podržati predlog AKR i da ćemo danas glasati da što pre prevaziđemo ovu krizu.

Još jednom se zahvaljujem svima onima koji su dali podršku i ujedno koristim priliku da ih zamolim da i u buduće zajednički radimo za dobrobit svih ljudi koji žive ovde. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branisllav Grbiq e ka fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Uvaženi predsedniče,

Gospodine premijeru,

Gospodo ministri i dame,

Gospodo narodni poslanici,

Nalazimo se očigledno na kraju jednog mandata jedne vlade i ono što želim da iznesem, to je niti ispred stranke, niti ispred grupe, ustvari želim da kao građanin Kosova, kao ličnost koja 53. godine živi na Kosovu i koji želi dobro Kosovu.

Bez obzira na celokupni proces koji se dešavao u svim ovim segmentima društvenim, kako u privrednom, tako i u institucionalnim, smatram da imamo pravo da ovog puta prihvatimo jednu sugestiju koja je u interesu, sigurno problema i rešavanja svih problema na Kosovu. To je nešto što je sastavni deo jednog institucionalnog procesa i tu ne vidim ništa loše.

Ovo je poverenje kao jedan samo čin jednog završetka ove vlade, koja sigurno da je imala uspeha i delimično možda i neuspeha, ali sada je to, svako će sa svog segmenta posmatrati to i reći, mi smo u prvu, mi nismo u prvu ili mi nismo imali, imali smo koristi ili nismo imali koristi. Ipak je ovo očigledno interes građana Kosova, svih pripadnika zajednica koje pripadaju Kosovu i svi pripadnici zajednica imaju pravo na to, bez obzira kojoj partiji pripadali. Ovog puta imaćemo znači jedan jako kratak mandat za rešavanja i sastav nove Vlade i izbor novih poslanika. To je znači od prilike, možda će biti tih mesec dana, gde će građani, pretpostavljam, po svojoj savesti morati da glasaju, jer definitivno na Kosovu mora da zaživi jedna istina, a to je istina građana Kosova, odnosno formalnih ili neformalnih koalicija, koalicija koje ništa ne nude dobro građanima. Znači, to mora da bude nešto što će građani Kosova prepoznati, bez obzira dali on pripada albanskoj zajednici, srpskoj, turskoj, romskoj, egipćanskoj i zato mislim da ovog puta Poslanička grupa za integracije podržaće ovu mociju sa razlogom jer slušajući premijera, smatrali smo da je ovo u interesu daljeg razvoja Kosova, interesa građana Kosova i da što pre, znači mora da dođe nova Vlada, koja će sagledati sve probleme koji su zaista veliki i uz pomoć međunarodne zajednice pokušati da otvori jedan novi put Kosovu ka evropskim institucijama.

To je nešto što svi mi moramo da podržimo i da bez obzira na lične sugestije i komplekse koje imamo ili bez obzira na sve, možda nismo to zadovoljni, ali sada moramo da prihvatimo neku činjenicu i da podjemo nekim novim putem da sagledamo svoje i slabosti i mane i da pogledamo građane Kosova i da im kažemo, mi smo ti ili nismo ti koji smo imali uspeha. Zato mislim, poslanička grupa podržaće ovu mociju i ujedno idemo dalje. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të lajmëruar kemi 28, po ky numër i deputetëve mund të shtohet. Nëse jeni dakord, shumica e diskutuesve deri më tani nuk kanë kaluar 5 - minutëshin, me përjashtim të deputetit Behxhet Pacolli dhe kryeministrit. Nëse pajtoheni, e shkurtrojmë debatin në 5 minuta. A është mjaftë? Kush është "për"? Ju faleminderit! Shumica. A ka kundër? 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, shumica janë për 5 minuta. Regjia, ka parasysh 5 - minutëshin.

Vazhdojmë. Jo, po vazhdojmë. Mendoj se jeni dakord të vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Shkunbin Demaliaj.

SHKUNBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot patëm rastin të dëgjojmë një fjalim tërheqës të zotit kryeministër, jo vetëm tërheqës për ta dëgjuar, por dhe tërheqës për të heqë dorë nga ajo që ka mund të arrijë deri me tash.

Patëm rastin që të shohim para vetes një kërkues edhe një sponzorizues. Kërkuesi dhe sponzorizuesi sot janë bashkë në një qëndrim, në këtë rast nuk po e them kushtimisht, po AKR-ja dhe PDK-ja janë bashkërisht në këtë edhe kjo verifikohet bashkë me nënshkrimin e deputetëve të këtyre partive për ta arritur numrin, edhe pse dyshoj në nënshkrimet, sepse ka edhe nënshkrime falso, ka nënshkrime falso, e them se neve kemi rastin kur një deputet që 3 muaj vetëm është i plagosur dhe nuk ka marrë pjesë në Kuvend dhe është i nënshkruar në listë, e them, për nënshkrimin dyshoj.

Tjetra, Qeveria, e ka thënë edhe zoti Gjini më herët, por e kam thënë edhe unë në seancën e fundit, është Qeveria e vetme në botë që po lypë ta shkarkojë veten, ata ju kanë thënë se keni për ta shkarkuar veten. Mirëpo, dihet se premtimet e dhëna, do të thotë, njohja e Kosovës nga 100 shtete për 3 muajt e parë, pas shpalljes së pavarësisë, kjo nuk ndodhi as pas 3 viteve. Qeveria është nën hetime nga EULEX-i, dihet shumë mirë. Kemi pasur hajni në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, po shkoj sipërfaqësisht, se i kanë përmendur edhe kolegët e tjerë, incidente me përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtarë të sigurisë, dihet, keni arrestuar mekanizmin e sigurisë të Bundesverit Gjerman dhe është dashur t'i lironi me turp, do të thotë, për të gjitha këto, kjo Qeveri nuk e ka realizuar asnjë premtim tjetër, përpos harxhimit të buxhetit të shkretë të qytetarëve, të tatimpaguesve të Kosovës.

Arsyeja është vetëm një edhe atë po e them kështu, se kjo Qeveri nuk ka pasur dhe nuk ka ardhur në pushtet me program qeverisës dhe kur nuk ka pasur program qeverisës, është dashur ta dijë se duhet të dështojë. Nuk po flasim për shkeljet kushtetuese e tjera, se po i thonë edhe kolegët, të mos përsëritmi shumë, edhe koha është e cunguar.

Zoti kryeministër, përfundimisht kërkoj nga ju, që pasi po kërkon vetëshkarkimin, ata u deklaruan edhe Grupi parlamentar i PDK-së, të përgjigjeni vetëm në një pyetje të shkurtër. Po, në radhë të parë një pyetje do t'ia dertoj vetë zotit Pacolli, se kur foli, kërkoj që të votohet mocioni, por nuk tha se do ta votoj vetë. Po më duket se nuk është i sigurt se a do jetë rezultati përfundimtar i votimit i sigurt, se a do të mbetet Qeveria apo do të shkojë, por për zotin kryeministër kisha kërkuar në një pyetje të shkurtër të më përgjigjeni: - A do të kërkon nga qytetarët e Kosovës të mos ju përkrahin më dhe t'ju kërkon falje për zhgënjimin. Kjo është pyetja kryesore. Kërkoj falje, kryeministër, shpresojmë se mandatin tjetër do të jemi pa PDK-në në Kuvend.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Mundësisht, secili deputet flet për veti, kështu që edhe ata që e kanë nënshkruar apo nuk e kanë nënshkruar, flasin vetë. Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë, para nja dy vitesh, këtu, ia kam pas dhënë një Kushtetutë sekretarit të PDK-së dhe i kam pas thënë - i thuaj kryetarit të Republikës së Kosovës ta lexojë por, si duket, nuk e ka lexuar, derisa e ka lexuar Gjykata Kushtetuese dhe kur e ka lexuar Gjykata Kushtetuese, e ka dhënë mendimin e vet, mendim i cili ka shkarkuar faktikisht, ka treguar se presidenti i vendit e ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, atëherë edhe tash, që 3 vjet radhazi unë kam kërkuar që kjo Qeveri të shkojë dhe është vështirë të dalësh kundër vetvetes që tash të thuash mos të shkoj. Ata që kanë kërkuar që kjo Qeveri të shkojë, kanë arsyet e veta dhe unë kam pasur arsyet e mia dhe tash do t'i përmend disa.

Ky koalicion qeveritar kur është lidhur, është lidhur mes dy burrave, e kam edhe atë letrën tjetër, si duket e harrova atje, në mes Fatmir Sejdiut dhe zotit Hashim Thaçi. Këta dy zotërinjtë e kanë lidhur koalicionin dhe kanë bërë pika të renditura një pas një në këtë koalicion, bile kishin pas shkruar që edhe të vetëm të hyjnë në zgjedhje, edhe në zgjedhje komunale, edhe në zgjedhjet nacionale. Si të tillë, duhet të shkojnë së bashku, sepse marrëveshja është në tri fletë, të tri fletat janë të shkruara nga dy burra, nga kryetari i Republikës, ish kryetar i Republikës, që e shkeli Kushtetutën, dhe nga kryeministri Hashim Thaçi. Ky është realiteti. Megjithatë, edhe ministrat e juaj, të nderuar, nuk kanë qenë milionerë edhe gjatë këtij mandati u bënë milionerë, nuk di kah i morën paratë. Nuk di se si mundën të bëhen brenda 3 vjetëve milionerë këta ministra, po edhe shoferët u bënë milionerë, edhe truprojat u bënë milionerë dhe kjo është pak për çudi, me këto para të taksapaguesve, të fukarenjve të Republikës së Kosovës.

Por, një po e them sinqerisht, mos mendoni që populli nuk i ka parë këto, i ka parë dhe i ka dëgjuar, i ka dëgjuar edhe nga foltorja e Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, një proverb, një fjalë e urët popullore thotë: “Me të lidhë dikush, të zgjidhë dikush, por me e lidhë veten, është problem me të zgjidhë dikush”. Si duket, sot dikush këtu po e lidhë veten dhe unë po pajtohem që po e lidhë vetën, jo që po e lidhi unë, por po pajtohem me atë që po e lidhë veten.

Unë, për fund do ta them, e kam dëgjuar një këngë të një grupi “Troja” po u thirrke dhe ajo po thoshte: “Kush janë këta njerëz që nuk kanë mësuar që shpinë e vet nuk bënë me e vjedhë, kush janë këta njerëz që diellin mua ma kanë ndalë” dhe po them prapë, unë do të jem ai që do të votoj mocionin, por jo mocionin, faktikisht ai është mocion në letër është ndryshe, por realiteti është ky dhe do ta votoj. Do ta votoj, sepse kam kërkuar që 3 vjet të shkojnë këta njerëz, që diellin na e kanë ndalë dhe sot do ta votoj.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Para dy vjetësh e gjysmë nga Qeveria e kemi marrë një dokument, në të cilën shkruante - Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Unë e kam marrë me veti sot dhe në ditët që është përfolur mocioni i mosbesimit, jam munduar të nxjerrë çka është realizuar nga ky program, i cili edhe atëherë është konsideruar si mjaft i dobët në cilësi dhe në përmbajtje. Tash po pyes - çka ka ndodhur me objektivat kryesore që i patët vu vetes kur e morët qeverisjen e vendit? Po ua përkujtoj: - rritjen ekonomike të qëndrueshme; zgjidhjen e krizës energjetike; infrastrukturën ekonomike; sundimin e rendit dhe të ligjit; ambient i sigurt; qeverisje e mirë; zbutje e varfërisë dhe e stabilitet social. Këto pak a shumë shkruajnë në këtë program që e kam marrë sot me veti.

Kur Grupi Parlamentar i Aleancës thoshte që këtë Qeveri nuk do ta rrëzoj askush, por do ta rrëzoni veten, ju nuk besonit, nuk e arritët ta përfundoni mandatin ashtu siç duhet, e keni shpikur mocionin si formulë, keni gjetur edhe argatë të mirë të cilëve u keni ndihmuar përmes presioneve në deputetë që ta nënshkruajnë mocionin dhe për këtë e keni gjetur pjesën më subtile, deputetët nga radhët e pakicave. Të gjitha këto, me qëllim të shfrytëzimit të mjegullës që krijohet nga organizmi i shpejtë i zgjedhjeve dhe për ironi, krejt këtë thoni se e bëni për interesat e popullit dhe të vendit.

Unë shkurtimisht dëshiroj të theksoj se në këto tri vite të qeverisjes keni dështuar të siguronit një rritje të qëndrueshme ekonomike. Keni trashëguar një rezervë mjetesh buxhetore prej 500 milionë euro, brenda 3 vitesh jo vetëm që nuk e keni zgjeruar bazën materiale të shtetit, por keni harxhuar rezervat e trashëguara, keni rrëmbyer dhe harxhuar fitimet e kompanive publike, po e dorëzoni mandatin pa buxhet të miratuar dhe me rrezik të krizës buxhetore për shkak të futjes së vendit në obligime pa mbulesë. Keni harxhuar paratë publike pa kriter, nuk keni investuar. Në këtë mandat trevjeçar, ju keni derdhur mbi 1 miliard e 200 milionë euro kinse për investime publike, por në fakt këtu ka ndodhur harxhim i parasë pa kriter përmes mekanizmave të prokurimit dhe mënyrave primitive të ndërmjetësimit në dhënien e tenderëve, paraja publike u shmang nga destinimi, u keqpërdor, prandaj vlera e saj u përgjysmua. Për këtë arsye, vendi ynë sot radhitet në grupin e vendeve më të korruptuara në botë dhe pa konkurrencë në vendin e parë për korrupsion në Evropë.

Keni dështuar të zgjidhni problemet në energjetikë. Në vend të fillimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja, siç ishte përgatitur, me qëllim që të shtrydhni investitorët potencialë, ju rifilluat procesin, e degraduat dhe tani vendi gjendet në krizën e thellë energjetike. Ju vetëm shpenzuat afër 200 milionë euro për blerje të energjisë dhe atë me çmim dyfish më të shtrenjtë se sa e blejnë vendet në regjion. Keni dështuar të krijoni klimë të favorshme për investitorët e jashtëm. Vendi ynë rrëshqiti në ranglistën për dhjetëra vende si vend më pak tërheqës për investime. Arsyet: korrupsioni i rritur, mungesa e rrymës, infrastrukturës dhe sundimit të ligjit.

Kosova tri vite pas pavarësisë vazhdon të jetë vendi më i varfër në Evropë. Papunësia është rritur, varfëria është rritur dhe varfëria e skajshme është rritur.

Ju nënshkruat një marrëveshje me pensionistët. Ata u mashtruan, ju votuan dhe tani janë dëshpëruar sepse asnjë obligim ndaj tyre nuk është përmbushur. Sot e kemi marrë edhe një letër nga strukturat e pensionistëve. Ju keni pretenduar për zgjidhje të problemeve në shëndetësi, çka keni rregulluar në këto vite në këtë sektor? Ju keni harxhuar dhjetëra miliona për lobim për Kosovën, sa u arsyetuan këto me njohje të reja apo ato u adaptuan për kompanitë që ju ndihmuan në fushatën parazgjedhore?! Pse ra eksporti dhe u përkeqësua bilanci tregtar me jashtë? Pse produktet bujqësore të Kosovës kalben nëpër depo, e Qeveria e Kosovës, në vend që të zgjidhjes së problemit, ju premtonte subvencionim të këtyre produkteve dhe shpenzim të parasë publike? Çka ndodhi me sektorin e minierave? Pse edhe investimet private ranë? Pse nuk publikoni kontratën për dhënien me koncesion të Aeroportit, kontratën për Autostradën, kah do të kalojë ajo rrugë dhe sa do të kushtojë? Pse ...

(ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti, Armend Zemaj. Nuk është, paska dalë jashtë. Atëherë, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues,
Kolegë deputetë,
I nderuar kryeministër,

Unë po i drejtohem kryetarit në detyrë, zotit Jakup Krasniqi, që pas certifikimit të zgjedhjeve për datën 13 shkurt, ta vlerësojë drejt politikisht, juridikisht dhe me gjithë dimensionin që e ka për shtetin, për institucionet, për zhvillimet politike se a mos po shkelet Kushtetuta dhe a mos po del jashtë kompetencave në rast se ky Parlament sot shpërndahet. Mocioni të cilin e kanë drejtuar sot në Parlament, unë mendoj që edhe në pikëpamje ligjore është jashtë kohe, jashtë momentit politik, pas certifikimit të zgjedhjeve për 13 shkurt, ku ishte një konsensus i të gjitha forcave politike.

Unë mendoj që është antikushtetues pas certifikimit të zgjedhjeve, sepse merreni dhe lexojeni pak më ndryshe edhe synimin, edhe qëllimin për të cilin sot shtrohet ky mocion. Unë mendoj që mocione të natyrës për vlerësimin e punës së Qeverisë, kanë mundur të mbahen në momente të tjera, në kohë të tjera për projekte, për politika zhvillimore, për politika të tjera dhe normalisht të jepet vlerësimi i drejtë politik dhe vendimi i drejtë parlamentar se çka duhet të bëhet me Qeverinë.

Unë, si një deputet i cili megjithatë jam përpjekur të jem konstruktiv, kritik dhe vlerësues, por mbi bazën e fakteve dhe argumenteve në punën e Qeverisë, përherë kam thënë se Qeveria për një vit e gjysmë deri në nëntorin e vitit të kaluar, unë mendoj që si Qeveri e pavarësisë së vendit ka punuar shkëlqyeshëm. Nuk e di çka e gjeti Qeverinë, kryeministrin dhe kolegët e tjerë të koalicionit, kush i bëri sehire nga dita e Zanzibarit e këndej. Nuk kam mundur, por jam përpjekur, kam kërkuar, kemi pasur do të thotë kritika, vlerësime, prandaj mendoj se prej asaj dite e këndej ka pasur arsye që çdo grup opozitar ta nxjerrë në mocion për të vlerësuar. Mua nuk më ka rënë si deputet, që kam qenë pjesë e koalicionit bashkë me kryeministrin, të marrë nisma të tilla sepse nuk është në rregull në Parlament, do t'i kisha kthyer ato parime, kritere, prandaj nuk kam dashur me i thyer, por do të isha bashkëngjitur me kohë në vlerësim të drejtë, në gjykim të drejtë, në alternativa të cilat do ta kishin kaluar situatën me sukses dhe me rregull. Sot, po e lexoj pak më ndryshe qëllimin dhe synimin e këtij mocioni nga ana politike, po që besa edhe nga vlerësimi që dëgjova këtu edhe nga fjala e kryeministrit dhe nga disa kolegë të tjerë që i adresuan në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Që të jemi korrekt pra, unë mendoj se duhet të shikohet, a thua unë e kam dilemën time si deputet, e kam ngritur në Parlament dhe po e pyes, vetëm një pyetje e kam për kryeministrin: - a ka dorë kryeministri në rrëzimin e presidentit përmes Gjykatës Kushtetuese? Kurgjë më shumë.

Tjetra, prej ditës kur është larguar presidenti nga detyra për shkak të detyrimit kushtetues, unë mendoj që koalicioni atë ditë ka përfunduar. Këtë e kam thënë edhe më herët dhe është dashur pra që vet kryeministri, si lidërs i PDK-së, bashkë me lidërsin e LDK-së të ulën dhe ta bëjnë një marrëveshje të re për qeverisjen e vendit në rrethana krejt të tjera për të mos dalë ose për të mos dyshuar unë për atë pyetjen që ia bëra. Prandaj, kjo nuk ka ndodhur dhe këtu duhet të shikohet zanafilla e krizës për të cilën po flasim. Prandaj, edhe një herë ky mocion kujtoj se është jashtë kohës, sepse nuk është mocion për ta rrëzuar Qeverinë e kryeministrit të koalicionit që e kemi zgjedhur më herët, por është mocion për t'i dhënë shans, do të thotë, për ta rrëzuar këtë parlament, të vendimin institucion demokratik, institucionin më të lartë në vend. Unë mendoj që është kjo ajo çka duhet lexuar nga këndi i dytë dhe unë mendoj se nuk keni të drejtë që Parlamentin ta shpërndani. Nuk ka të drejtë me kompetenca kushtetuese as ushtruesi i detyrës së kryetarit.

Prandaj, unë kërkoj, nëse jemi parimor, nëse e duam vendin, nëse e duam atë zhvillim që e tha edhe ...

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

U përmendën nga parafolësit shumë afëra korruptive që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe të qeverisjes, u përmendën si arsye edhe keqqeverisja, keqqeverisja të mos jetë ajo si zhargon kështu, si togfjalësh, por korupsioni me fjalë trup e shkurt, hajnitë nëpër institucionet e Kosovës, por edhe në institucionet jashtë qeveritare, ku krimi i organizuar dhe korupsioni është në maksimum. Këto i thonë edhe raportet ndërkombëtare.

Gjithsesi, unë kam pritur që kjo Qeveri të bie si rezultat i këtyre aferave, të bie si rezultat i përplasjeve dhe i hetimeve që ndodhën nga EULEX-i, në mungesë të vullnetit politik nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila ishte e zënë më shumë me mbulimin e hajnive se sa me gjetjen e tyre, mund të ishte e zënë, sepse asnjë rezultat konkret deri tash nuk e kemi parë. Dhe, çështja ishte pak më dëshpëruese edhe për shkak të deklaratave të fundit të z. Marnak, shefit të EULEX-it, i cili filloi të merret me punë të Shoqërisë Civile, me barazi gjinore, me të drejtat në familje, duke pasur parasysh njëqindmijë punë që i ka me korupsion në Kosovë.

Zotimi për të respektuar Kushtetutën, do të thotë që është zotim që Kushtetuta dhe ligjet të respektohen nga të gjithë, që të gjithë individualisht apo edhe të organizuar në grupe politike, parti, të respektojnë kushtet dhe ligjet për të gjithë, pa dallim. Pra, të zhvillojmë demokracinë, e për këtë duhen zgjedhjet demokratike të qytetarëve të Kosovës, sepse do të duhej që në mënyrë demokratike të bëjmë zgjedhje nga ata që i plotësojnë rregullat për zgjedhje, që qytetarët të zgjedhin nga të gjithë ata të cilët i respektojnë ligjet. Pra, KQZ është ajo që vendos ligjet zgjedhore, rregullat e zgjedhjeve dhe unë po mbës me shpresë se do ta mbrojnë dhe nuk do të dorëzohet para tyre që pretendojnë apo mund të pretendojnë të hyjnë në zgjedhje pa i respektuar ligjet dhe rregullat e demokracive të brendshme, pa kuvendet e veta zgjedhore. Që të zhvillohet demokracia, duhet të zhvillohet demokracia e brendshme, kusht që është vënë nga infrastruktura ligjore e Kosovës. Secila fjalë mbi Kushtetutën, respektimin e Kushtetutës, respektimin e ligjeve, bie peshë, humb besimi tek qytetarët se u beson atyre fjalëve, nëse partia më e madhe në vend mund të certifikohet në zgjedhjet që potencialisht mund të vijnë në muajt që vinë.

Duke parasysh faktin se Kuvendi i fundit i Partisë Demokratike të Kosovës nuk ka mbajtur kuvendet e veta, nuk e ka mbajtur demokracinë e brendshme, nuk mund të flitet për demokraci në Kosovë. Këto mund të jenë vetëm farsa demokratike. Edhe unë bëj lutje, bëj lutje, singërisht lutje që t'i japim botës shembull, që qytetarëve t'u japim shpresën, që dy hapat kryesor Kosova që mund t'i bëjë, hapi i parë ka qenë dhe është plotësuar, që ka kërkuar nga presidenti i vendit ta respektojë Kushtetutën e Kosovës, se askush nuk është mbi Kushtetutën. Tash, që edhe vetë Partia Demokratike të kërkojë afat që t'i nënshtrohet Kuvendit të vet zgjedhor. Ky do të ishte shembulli më i mirë se jemi të determinuar, se jemi të përcaktuar për zhvillim të demokracisë në Kosovë.

Secili hap ndryshe nga ky, do të na gjejë i njëjti edhe do krenohemi me atë që kemi qenë vitin e kaluar në vendin e 110-të, se sipas Transparence Internatoonal, mund të biem edhe në vendin e 150-të. Demokracia është në korelacion të drejtpërdrejtë me sundimin e ligjit. Pa zhvillim demokratik, nuk ka sundim të ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sa i përket partisë, ti më nuk je në parti dhe ne e kemi zgjidhur vet këtë problem tonin, kështu që...

Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Pas mbështetjes që i dha Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, gjegjësisht pas fjalës së kryetarit të Grupit, zotit Buja, nuk e kisha ndërmend të flas, por duke pasur parasysh diskutimet dhe debatin që edhe kjo seancë përpiqet të shfrytëzohet si instrument apo foltorja e parlamentit si instrument i fushatës zgjedhore, domodoshmërisht më duhet që të reagoj dhe t'i bëj disa sqarime.

Mbështetja që i bën Gripi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, mocionit, nuk është një mbështetje për mosbesim ndaj Qeverisë, për mendimin tim, sepse kësaj pjese të Qeverisë që ka mbetur na i besojmë plotësisht dhe e përgëzojmë për punët dhe suksesin që e ka bërë.

Po i dëgjoj që dikujt ju kanë përzier shifrat, por e vërteta është se gjatë këtij mandati janë dyfishuar pensionet, janë rritur rrogat në të gjithë sektorët, edhe në Administratë Publike, edhe në polici, edhe në arsim, edhe në shëndetësi, gjë që është e arritur dhe duhet të përmendet. Janë bërë shumë përparime. Në këtë Parlament ka pasur shumë krijime të problemeve nga kolegët nga opozita, por asnjëherë nuk kanë ofruar zgjidhje, zgjidhje po mbetet që edhe sot kësaj shtate të shkaktuar pa dëshirën e Partisë Demokratike të Kosovës, por pas shkeljeve që janë bërë nga ish kreu i vendit dhe nga tërheqja e Lidhjes Demokratike të Kosovës nga pozitat ministrore, Partisë Demokratike të Kosovës në njëfarë mënyre i imponohet që të bëjë zgjidhje dhe që ta dëshmojë atë çka e karakterizon këtë parti, sakrifica. Deri tash dihet që një prej karakteristikave të veprimtarëve, të anëtarëve të Partisë Demokratike të Kosovës ka qenë gjithmonë gatishmëria për sakrificë, por për herë të parë i jepet rasti dhe mundësia që të bëjë një sakrificë politike, e kjo e dëshmon se Partia Demokratike e Kosovës, më shumë se sa për pushtet, angazhohet për shtet, në mënyrë që të krijojë stabilitet, në mënyrë që të krijojë edhe stabilitet politikë edhe stabilitet institucional.

Ne dhe unë, personalisht, edhe si një veprimtar që kam më shumë se gjysmën e jetës të investuar qoftë për liri, qoftë për ndërtim dhe demokratizim të shoqërisë, e mbështes këtë mocion dhe shpresoj që në mandatin tjetër do të kemi deputetë edhe nga opozita, të cilët ofrojnë zgjidhje dhe nuk krijojnë probleme, të cilët interesohen për të mirën e publikut, për të mirën e qytetarit dhe përfaqësojnë, mësohen të përfaqësojnë interesin e qytetarit në këtë Kuvend dhe të mos bëjnë citate të shkurta nga raporte të institucioneve të ndryshme apo të shoqatave të ndryshme dhe me ato citate të përpiqen të manipulojnë edhe Parlamentin, edhe opinionin tonë publik. Por, mbase edhe diskutuesi paraprak është i shqetësuar, sepse nuk dëgjohej fjala e qytetarit, nuk dëgjohej prindi i cili dy, tre ose 5 fëmijët e tij i marrin librat falas, nuk dëgjohej edhe plaku apo e ka shqetësuar një plak, një bashkëfshatar mbase i diskutuesit paraprak, i cili e ka kaluar jetën, është në fund të jetës së tij dhe tash ka parë mundësinë që i zgjidhet një problem jetik dhe thotë: “unë edhe 60 vjet nuk do t'i kisha ndërruar këta njerëz”.

Prandaj, këtu është shqetësimi i disa kolegëve nga opozita, të cilët në fillim, gjatë vitit 2008, thoshin se Qeveria po merret me ndërtimin e rrugicave. Pasi përfunduan rrugicat dhe filloi ndërtimi

i autostradës, prapë thonë - përse po ndërtohet autostrada. Prandaj, po them që në këtë parlament ka pasur shumë deputetë, të cilët kanë krijuar probleme, por nuk kanë ofruar zgjidhje dhe besoj që në mandatin tjetër dikush do të shkojë t'i mësojë shifrat e dikush do të shkojë të dëgjojë këngë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pauza deri në orën 15:30

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: OK. Atëherë, po vazhdojmë me debatin, mendoj që janë bërë më shumë se 10 minuta. Të drejtë kemi që ta vazhdojmë. Nuk jemi të varur në prej shefit. Nuk po di kujt t'ia jap fjalën të parit.

Atëherë, fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Sot është një ditë e veçantë për Kosovën dhe për këtë Kuvend, për shumë arsye. Sjellja e mocionit për votëbesimin e Qeverisë, të cilin e mbështet vetë Qeveria, më asocion sikur një njeri i cili vetë plagoset rëndë dhe shkon te mjeku dhe i thotë: "a mund të konstatosh që jam plagosur". Kjo Qeveri është vetë plagosur rëndë. Ky koalicion qeverisës ka dështuar. Vetë fakti që është shpërbërës si koalicion qeverisës, para mandatit, do të thotë kemi të bëjmë me një koalicion të dështuar qeverisës.

Unë nuk dua të hyjë në përsëritjen e shumë parafolësve të mi për dështimet që i ka pasur ky koalicion qeverisës gjatë udhëheqjes me Qeverinë e Kosovës, por më lejoni që edhe si qytetar i Kosovës të them se për çka do të mbahet mend ky koalicion qeverisës.

Ky koalicion qeverisës do të mbahet në mend dhe kjo garniturë politikanësh, por edhe ky Kuvend, që e kanë prodhuar një president që do të jetë në historinë e Kosovës presidenti i parë që shkarkohet për shkak të shkeljeve të rënda të Kushtetutës të Kosovës.

Ky Kuvend dhe kjo Qeveri do të mbahet në mend edhe për faktin se është mundur me çdo kusht ta privatizojë aktin e shpalljes së pavarësisë, ta bëjë meritore dhe meritore një spektër ose një grup sa më të vogël njerëzish ose vetëm një parti politike. Qytetarëve të Kosovës ju kujtohet heqja e fotografisë të presidentit Rugova nga holli dhe mosftesa e përfaqësuesve të familjes Haradinaj për ta ngushtuar meritën dhe për ta privatizuar pavarësinë e Kosovës. Ky koalicion qeverisës do të mbahet në mend me Zanzibarin dhe është quajtur Qeveria e Zanzibarit. Para një kafeneje, mbahet konferencë për shtyp para gazetarëve dhe shpallet që koalicioni qeverisës mori fund, jo para Qeverisë, jo para ndërtesës, jo në mjetet e Qeverisë së Kosovës.

Ky koalicion qeverisës do të mbahet në mend se kryeministri, në fjalën e tij në pikën e rendit të ditës për votëbesimin e Qeverisë kërkon nga deputetët që të shkarkohet Qeveria. A do të ketë ndokund ndonjë herë kryeministër që kërkon para Kuvendit që të shkarkohet vetë. Kjo Qeveri dhe ky koalicion qeverisës do të mbahet në mend që edhe pasi iu ka tërhequr gjysma e ministrave, dhe ju e dini si janë tërhequr, nuk e jep dorëheqjen. Në çdo vend demokratik, kulturë dhe rregull i parë demokratik është që vetëm një votë në Kuvend kur bien mazhoranca për një votë në pakicë, vetë Qeveria e ofron dorëheqjen dhe më është Qeveri në dorëheqje. Dhe, krejt në

fund, ky koalicion qeverisës ka për t'u mbajtur në mend me atë fotografinë e braktisjes së ndërtesave të Ministrisë nga ana e ministrave të kësaj Qeverie. Krekoseshin se me sa krenari po i braktisin ndërtesat e Qeverisë, që janë zgjedhur me votat e këtij Kuvendi dhe që e kanë marrë mandatin e këtij populli.

As kur janë tërhequr, kur kanë dhënë dorëheqje funksionarë e të tjerë prej masave të dhunshme, nuk janë krekosur aq fortë para kamerave sa ministrat e kësaj Qeverie. Kjo Qeveri dhe ky koalicion do të mbahet në mend, që qytetarët e Kosovës as sot nuk e dinë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë të Kosovës, ju të cilët e keni përcjellë punën e Parlamentit, e dini, por ata të cilët nuk e kanë përcjellë, do t'ju them se dy momente që më kanë lënë përshtypje dhe më kanë bërë që të mbetet në kujtesë, janë momenti kur ministri i Arsimit, më falni ministri shumë i përfolur apo shumë i dyshuar për korrupsion, zoti Enver Hoxhaj, votoi kundër "dëshirës së Qeverisë", po them në thonjëza gjithnjë, dhe momenti tjetër kur dy deputetët më të zëshëm në mbrojtje që i dolën kësaj Qeverie, pra flas për zotin Hajdin Abazi dhe sidomos për zotin Gani Buçinca, i cili madje një herë patë deklaruar se kjo Qeveri është më e mira në globin tokësor dhe këta nënshkruajnë mocionin për ta rrëzuar këtë Qeveri.

Kjo edhe fjalimi i sodit i zotit kryeministër, por edhe ai fjalimi i djeshëm, kur iu drejtua qytetarëve të Kosovës, tregon padyshim se kjo iniciativë është nisur nga PDK-ja për interesat e saja, sepse nuk mund të flasin në emër të Kushtetutës ata të cilët me dy këmbë e kanë shkelur për interesat e xhepave të tyre të njëjtën Kushtetutë, si bie fjala privatizimi i PTK-së, ku ende pa e marrë miratimin e Kuvendit, kjo Qeveri hapi tenderin për privatizim sepse, siç dihet, shprehja e interesit apo publikimi, hapja e shprehjes së interesit është edhe fillimi apo faza e parë e procesit apo procedurës së privatizimit. Pra, shkelet Ligji për ndërmarrjet publike me dy këmbë, shkelet Kushtetuta dhe jo vetëm që askush nuk merret në burg, tjetër kund ishin marrë në burg ata të cilët e kanë bërë këtë veprim, këtu as që merren në përgjegjësi.

Nëse me të vërtetë dëshirojmë ta zgjidhim këtë "krizë", ka mundur kjo Qeveri, sepse kriza e vërtetë ka filluar apo ka qenë që nga janari i vitit 2008, nëse nuk gabo, 18 janar, kur ky qift u kurorëzua dhe u bë kjo martesë joparimore, e cila e shkeli me dy këmbët demokracinë, ishte në vazhdimësi krizë institucionale dhe krizë demokratike. Tash ka filluar ko krizë të zgjidhet. Kjo Qeveri nuk bën asgjë edhe kur zyrtarët e lartë të Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale dalin publikisht dhe e tregojnë vulën falco, vulë me të cilën kanë hyrë medikamentet, kanë hyrë barnat pa kurrfarë standardesh, të skaduara, na vdesin pacientët, askush nuk merret në përgjegjësi, por pse kanë dalë disa ministra, "ekspertë", koka bë nami. Na vdesin njerëzit, askush nuk merret në përgjegjësi. Dalin disa ministra që, së pari, shumicën as që dimë çka kanë bërë, disa herë kanë punuar keq e më keq, tash bëhet kiameti, hyjnë në krizë. Përkundrazi, tash është kriza kah zgjidhet. Unë, po them, nëse do PDK-ja me të vërtetë ta zgjidhë apo të punojë karshi Kushtetutës, së pari duhet ta mbajnë Kuvendin e tyre zgjedhor konform Kushtetutës, sepse nuk mbahet Kuvendi zgjedhor me delegatët të cilëve ju ka kaluar mandati, me delegatët e vjetër të cilët nuk janë zgjedhur nga baza.

Së pari, mbani kuvendin, siç ju duhet, jepuni urrek të vjetërve qysh duhet respektuar Kushtetuta, qysh të respektohet demokracia, pastaj kërkon dorëheqje. Në fund të fundit, ka mundur që

Kryeministri të japë dorëheqje, të vijë një Qeveri teknike dhe mos të bëhet kiameti. Kriza është më e madhe se njerëzit që nuk kanë, nuk kanë gjërat më elementare për jetë, për ato le të brengoset Qeveria, e jo pse paskan shkuar nja dy-tre ministra, që edhe ashtu kurrë nuk kanë bërë, shumë mirë që kanë shkuar. Më e mira ka qenë sikur të mos ishin zgjedhur fare ata, të mos ishin zgjedhur ata. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami .

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra deputetë,

Më lejoni që në fillim të ndalem pak në kontekstin në të cilin po shtrohet ky mocion dhe të theksoj se ky mocion nuk po shtrohet në kontekstin e një kontrolli normal parlamentar, që është normale për demokratitë parlamentare, por po shpresoj në kontekstin e gjetjes së një zgjidhjeje kushtetuese për tejkalimin e kësaj situatë, e cila në një mënyrë e ka paralizuar funksionimin e institucioneve.

Unë për këtë arsye e mbështes plotësisht këtë mocion të Aleancës Kosova e Re dhe të 40 deputetëve dhe e shoh si një përgjegjësi politike që Kuvendi i Kosovës të gjejë një rrugë kushtetuese për të dalë nga kjo krizë politike, e cila, siç dihet, e ka shkakun dhe pasojën. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se Kosova ka hyrë në një krizë të tillë kushtetuese pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ku ka eskaluar kjo krizë edhe me daljen e njëanshme dhe të paskrupullt të ministrave nga Qeveria dhe, si pasojë e tillë, ka ardhur deri te zvogëlimi i kapacitetit kushtetues të të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës dhe, natyrisht, në një situatë të tillë, të gjithë duhet të demonstrojmë përgjegjësi politike për dalje nga situata dhe për fuqizimin kushtetues të institucioneve, sepse po të ndodhte një fenomen i tillë në demokracitë me përvojë të gjatë parlamentare, nuk do të ishte një problem sepse, duhet ta pranojmë, ky është një fenomen tipik për demokracitë parlamentare, por po ndodhë në një shtet të ri, në një shtet të ri që përballlet me sfida shumë serioze dhe çfarëdo dobësimi i institucioneve të Kosovës, krijon dëme të pariparueshme.

Në anën tjetër, dëshiroj të përshëndes faktin që kryeministri nuk ka dashur ta zgjidhë këtë situatë në mënyrë të njëanshme, që ndodhë në shumë vende, përmes procesit të një dorëheqjeje, por ka kërkuar që kjo të shkojë në një rrugë parlamentare, me një përgjegjësi politike të parlamentit, si organ më i lartë, në mënyrë që vendit t'i hapet rruga për krijimin e legjitimitetit tani të cunguar të institucioneve demokratike. Me këtë ne po japim padyshim rast institucionit të përgjegjësisë politike dhe faktet që ne duhet t'i dallojmë në situata çfarë është kjo, interesat shtetërore nga ato interesat politike, sepse po të shihen vetëm interesat e shkurta politike, Partia Demokratike e Kosovës do të mund të gjente rrugë që të krijonte një Qeveri të pakicës dhe të shpenzonte krejt mandatin që e ka marrë në zgjedhjet e kaluara. Por, me këtë po demonstrohet vërtet një përgjegjësi politike që në situata krize të mos ketë përfitime politike, por ato situata të zgjidhen me mjete kushtetuese. Për këtë arsye, mendoj se tani nuk kemi përpara një mocion klasik të votimit për mocionin e mosbesimit të Qeverisë, por kemi një situatë që me mjete kushtetuese, me rrugë kushtetuese t'i japim mundësi krijimit të legjitimitetit demokratik të institucioneve të Kosovës, sidomos karshi problemeve me të cilat ne do të sfidohemi, problemeve të shtetit të ri që ka një agjendë politike mjaft të njohur.

Për këtë arsye, mendoj se ne duhet t'i lëmë sot anash këto debate politike, tipike opozitare, sepse ato dhe nuk janë shtruar sot për diskutim. Ka pasur kohë të shtrohet. Këto institucione dhe kjo Qeveri, tani gati po bëhen tri vite dhe kanë mundur të ushtrohen me dhjetëra seanca, jo vetëm të mocionit të mosbesimit, por edhe të mocioneve tjera, por të gjithë duhet të ndërgjegjësohemi se

vendi ynë nuk ka zgjidhje tjetër, nuk ka zgjidhje tjetër dhe nuk duhet ta lejojmë t'i japim vetit një komoditet që të lëmë këtë situatë dhe të krijojmë këtë vakum institucional në veprimin politik. Për këtë arsye, mendoj se ne jemi para një përgjegjësie të përbashkët, që përmes votimit të mosbesimit të Qeverisë të krijojmë institucione të përgjegjshme politike dhe në një mënyrë të tregojmë që Kosova, edhe pse shtet i ri me tradita të reja parlamentare, është e aftë të përballet me këto sfida, që megjithatë janë fenomene demokratike, por janë demokratike në qoftë se ato rezultojnë me zgjidhje adekuate kushtetuese dhe në qoftë se ato mundësojnë vërtet një proces normal të demokracisë dhe mundësojnë që institucionet të legjitimohen tani me legjitimitet të ri zgjedhor dhe, si të tilla, ato të fuqizohen për t'u përballur me kompetenca të plota çfarë ato i presin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Qeveri në mosbesim,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur,

Situata e sotme nuk është rezultat i krizës institucionale ose të krizës politike, siç e quajti kryeministri. Situata e sotme është prodhim i qeverisjes Thaçi. Sot jemi këtu sepse Qeveria Thaçi punoi për interesat e veta. Sot po e shqyrtojmë mocionin për votëbesim ndaj Qeverisë, sepse koalicioni qeverisës PDK-LDK nuk u krijua për interesa të shtetit, por të pushtetit. Po e shqyrtojmë mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë, të iniciuar nga AKR-ja, që është e afërt me pushtetin mbase pse fitoi tenderët. Paradoks i llojit të vet, që deputetët e PDK-së nënshkruan mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë, paradoks edhe më i madh është se i gjithë grupi parlamentar do ta rrëzojë qeverinë e vet. A nuk kenë besim në Qeverinë tuaj?

Pas kësaj, mbase Parlamenti do të shpërndahet, realisht Parlamenti do ta shpërndajë vetveten. Në asnjë qeveri tjetër të Kosovës nuk ndodhi kjo gjë, në asnjë parlament tjetër të mëhershëm nuk ndodhi kjo gjë. Po ngutet kryeministri të mbajë zgjedhje të parakohshme shpejt e shpejt, edhe pse dihet se në vendet e zhvilluara, me demokraci të konsoliduar, për 45 ditë nuk mund të mbahen zgjedhje cilësore dhe jo aspak fer dhe demokratike ose të lira.

Në të gjitha veprimet e veta, Qeveria nuk punoi për popullin, për interesin e tij. Nuk është mërzitur Qeveria kur e ka shqetësuar popullin dhe e ka lënë tërë natën pa gjumë kur shpalli nga Zanzibari, një lokal afër selisë të PDK-së, se është prishur koalicioni ose kur bëri riformatimin e Qeverisë, duke ndërruar ministrat që ishte më së lehti të ndërrohen, më pak e dhimbshme për PDK-në dhe LDK-në. Kjo ishte lufta e pa kompromis e Qeverisë kundër korrupsionit. Nuk mërzitet as tani për zgjedhjet, kur qytetarët duhet të dalin dhe të votojnë në kohë të ftohtë dhe në terr. Nuk shqetësohet se zgjedhjet jociësore mund të kontestohen dhe të shkaktojnë probleme. Me rëndësi është që Hashim Tahçi të mbetet në pushtet me çdo kusht dhe me çdo çmim, me çmimin e dëmtimit të shtetit dhe të interesave të popullit të Kosovës.

Më e dhimbshmja nga të gjitha këto është se çmimin e kësaj Qeverie do ta paguajë populli i Kosovës.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Gjatë tre vjetëve të qeverisjes Thaçi, gjendja në veri u përkeqësua. Krimi i organizuar lulëzoi, korrupsioni u rrit, papunësia u shtua, familjet u varfëruan, ekonomia nuk u zhvillua. Mediet u kontrolluan, Kuvendi u nënshtrua, Kushtetuta dhe ligji u shkelën, demokracia u dëmtua, njohjet e

Kosovës ngecën, shëndetësia u mjerua, gjyqësia ngeli e pareformuar. Mbetëm i vetmi vend në Ballkan i izoluar.

Kjo Qeveri nuk punoi për qytetarin, por për qeveritarin, prandaj unë do të votoj për atë çka është më së miri dhe në interes të popullit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra, edhe sot,

Të nderuar kolegë deputetë,

E konsideroj të nevojshme t'i them nga dy fjalë lidhur me mocionin. E tha edhe profesor Arsim Bajrami, shkaktari i mocionit është kriza politike dhe institucionale në vend. Ndërkaq, shkaktari i krizës politike dhe institucionale në vend mund të jetë mosfunksionimi i një koalicioni jo të natyrshëm, që e kemi parë të gjithë dhe i cili shkoi ashtu, si erdhi.

Ndërkaq, tani duhet të them, të ndalem te ajo që opozita në forma të ndryshme, mënyrën e menaxhimit, se tek e fundit qeverisja e mirë ose jo e mirë e një vendi është mënyra e menaxhimit të resurseve edhe humane, edhe ekonomike, edhe natyrore që i ka një vend nga ana e klasës politike që përmes përfaqësimit në Kuvend vjen në Qeveri dhe, natyrisht, opozita ka shprehur në forma të ndryshme pakënaqësinë me mënyrën e menaxhimit të këtyre resurseve për plotë 3 vjet.

Ato premtime që janë dhënë, natyrisht, nuk janë realizuar, nuk është realizuar mirëqenia e premtuar, nuk është sjellë, nuk janë krijuar më shumë vende pune, nuk është pakësuar korrupsioni, nuk është krijuar më shumë siguri në vend, kjo Qeveri nuk ka sjellë liberalizimin e vizave, shumë pak e ka përafruar Kosovën me proceset e integritetit në BE dhe shumë pak ka bërë në procesin e legjitimitetit të statusit të saj në marrëdhënie ndërkombëtare përmes rrugës së njohjeve, përkatësisht krijimit të marrëdhënieve bilaterale veç e veç me shtetet, meqë nuk kishte rrugë tjetër për Kosovën.

Do të ndalem plak te kjo e fundit, meqë e konsideroj veten pak më kompetent. Kjo Qeveri nuk e ka kuptuar asnjëherë plotësisht rolin që e kishte në krijimin e imazhit të vendit tonë në marrëdhënie ndërkombëtare. Pra, asnjëherë nuk ka arritur të ngritë kapacitete të mjaftueshme për t'u përballur me këtë sfidë e cila ka qenë po aq e rëndësishme për shtetin e ri të Kosovës, sa edhe politika e brendshme, përkatësisht zhvillimi ekonomik dhe krijimi i një shteti ligjor, i sundimit të rendit dhe të ligjit.

Unë po i përmendi vetëm ato që konsideroj se nuk janë bërë në mënyrë të plotë ose nuk janë bërë fare ose nuk janë bërë ashtu si duhet. Ka pasur pak, është shpenzuar pak energji dhe pak, si të them, ka pasur pak punë dhe rezultate, sidomos në drejtim të legjitimitetit të statusit përmes lobimit për njohje. Janë vonuar shumë, përkatësisht nuk janë konsoliduar asnjëherë kapacitetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka pasur vonesa të konsiderueshme në ngritjen e Shërbimit Diplomatik të Kosovës dhe ka mangësi dhe defekte të vazhdueshme në këtë segment. Nuk është shfrytëzuar, pra asnjëherë nuk është ndërtuar si duhet ajo që quhet - politikë e jashtme e Kosovës, përkatësisht nuk është funksionalizuar diplomacia e Kosovës.

Në këtë segment, në këtë dikaster të kësaj Qeverie ka pasur nepotizëm që nga zyrtarët më të lartë të kësaj ministrie, deri te përfaqësuesit më të skajshëm në misionet diplomatike të Kosovës. Nuk

dua të përmend emra, sepse opinioni i di, po i ke nga dy tre familjarë, që janë ose konsuj ose janë ambasadorë ose zëdhënës ose diçka në një ministri. Këto i kemi vërejtur dhe opinioni i ka parë. Ka pasur paaftësi pra të vazhdueshme, është dëshmuar paaftësi e vazhdueshme në shfrytëzimin e momentumit të mirë, në shfrytëzimin e momentumit që ka krijuar mendimi pozitiv, mendimi afirmativ i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në vend që Kosova ta ligjësonte këtë mendim përmes një rezolute në Këshillin e Sigurimit, Serbia e pamundësoi këtë rezolutë dhe ofroi një rezolutë të saj, e cila bëhet rezolutë edhe Bashkimit Evropian, që e fut detyrimisht Kosovën në një proces negocimi me Serbinë, të cilat thuhet se do të jenë bisedime teknike, por ende nuk e dimë çfarë do të jenë.

Ka pasur paaftësi të vazhdueshme për t'u bërë, pra nga ana e kësaj Qeverie dhe dikasterit në fjalë, për t'u bërë palë e barabartë e komunikimit me Brukselin dhe Uashingtonin, sidomos me Brukselin, dhe shihni proceset e përafrimit të Serbisë dhe të Kosovës në drejtim të Brukselit, janë disavantazhe të mëdha që po i krijohen Kosovës pikërisht në këto kohë kur Serbia po paralajmërohet se do të marrë edhe karota tjera nga Brukseli, ndërkaj Kosova nuk po e merr asnjë nga ato dhe ka rrezik që Serbia nga karotat e shumta do të....

(Ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës!

Jemi në Kuvendin e Kosovës,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke dëgjuar diskutuesit ose kolegët e mi në këtë Kuvend, më krijohet përshtypja se ne po diskutojmë raportin nëntëvjeçar të punës të Qeverisë ose atë vjetor të punës të Qeverisë dhe jo një kërkesë të një grupi parlamentar që me të drejtë e shtron në një situatë, në një rrethanë të krijuar, pa dashjen e Qeverisë, pa dashjen e grupit më të madh politik ose parlamentar që është këtu në Kuvend dhe mirë është që ne na u ka dhënë rasti, bile ndoshta dikujt rasti i fundit që këtu të zbrazemi dhe mirë është që të zbrazemi, por një gjë dua t'ju them. Ne e kemi një mocion përpara dhe duhet të deklarojemi rreth atij mocioni. Është një e drejtë kushtetuese ose një rrethanë juridike e krijuar mbi bazën e të cilës kemi zgjidhje që duhet të dalim prej saj dhe është e jona ta pranojmë atë zgjidhje apo mos ta pranojmë atë zgjidhje. Mendimi i të gjithëve është se duhet pranuar, në mënyrë që të dalim nga kjo gjendje. Për sa u përket raporteve të punës, të progresit, të sukseseve, të dështimeve të kësaj strukture, tash të këtij kostelacioni qeveritar, ne kemi mjaftë kohë që të flasim ose ata që do të vinë nesër që të na i zënë vendet këtu, sigurisht që do t'i shtrojnë edhe këto çështje.

Prandaj, unë dola këtu që t'ju them, ju lutem, mos të rrëshqasim nga tema të cilën ne e kemi shtruar këtu, për mocionin. Nuk po flasim për sukseset ose mos sukseset e kësaj Qeverie, që mund të ketë edhe nga njëra anë, edhe nga ana tjetër, por unë mendoj që sukseset janë të shumta, vetëm ata që janë të verbër, nuk donë t'i shohin, por ka natyrisht edhe dështime, po ne të deklarojemi dhe të dalim nga kjo situatë. Duhet të vazhdojë kjo qeverisje e përgjysmuar, gjysmake, që nuk mund të shkojë më tutje, apo duhet të respektohet Kushtetuta dhe në këso raste dhe në këso rrethanash të marrim një veprim kushtetues dhe një veprim ligjor që të dalim nga kjo gjendje. Unë mendoj që duhet ta marrim atë qëndrim dhe atë veprim. Dikush tha që Qeveria do ta

rrëzojë vetveten. Ju lutem, këqyrni praktikat parlamentare, ata që e njohin pak, më vjen keq të flas para profesorit tim këtu të të drejtës kushtetuese, por shpeshherë qeveritë dhe kryeministrat kërkojnë votëbesimin vet dhe nuk u jepet ai votëbesim dhe e bëjnë një kabinet tjetër qeveritar. Por, na e kemi një rrethanë tjetër, kemi rrethanën që koalicioni është dalë, është larguar, dyert janë mbyllur siç është thënë, prandaj duhet të hapen ato dyer dhe hapja e atyre dyerve është që të votohet kërkesa e Grupit Parlamentar të AKR-së, në këtë rast, dhe pastaj të vazhdohet sipas procedurave dhe rregullave në veprime dhe punë tjera që i ka për detyrë tash ushtruesi i detyrës të presidentit të Republikës së Kosovës. Nuk besoj se zoti Jakup Krasniqi e ka dëshiruar edhe këtë gjendje që tash të mbajë dy funksione dhe të ketë dy përgjegjësi në këtë situatë dhe në këto rrethana.

(Reagime nga salla)

GANI KOKCI: Shkumbin, të respektoj shumë, që çmoj shumë, shumë të çmoj, por një duhet ta dimë. Kur të falsin për sukseset dhe mossukseset e kësaj qeverisjeje, ju lutem, ne kemi qenë nëpër komisione parlamentare edhe të Buxhetit edhe të Kontrollit të Buxhetit dhe i kemi parë vlerësimet edhe të auditorëve dhe ato vlerësime i kemi shqyrtuar bashkërisht, i kemi pasur edhe këtu në Kuvend, prandaj mendoj që kjo nuk është temë dhe nuk do të duhej të ishte temë e diskutimit këtu.

I kuptoj ata që do të jenë për herë të fundit në diskutim, shumë i kuptoj. Prandaj, kisha dëshiruar që t'u japim hapësirë më të madhe atyre që të flasin dhe të zbrazen këtu. Unë vetëm një gjë dua të them, që Partia Demokratike nuk e ka dëshiruar këtë, po Partia Demokratike është ajo që e tha edhe kryeministri, të respektojë rendin, ligjin dhe kushtetutën. Rendi, ligji dhe kushtetuta e thotë se koalicioni na ka prurë në një situatë të tillë ose anëtar i koalicionit që ne duhet të marrim këto veprime dhe koalicionet, shpesh po dëgjohet, janë jo të natyrshme. Gjithmonë koalicionet janë jo të natyrshme sepse bëhen dy grupime që kanë interesa të ndryshme, bëhen bashkë dhe gjejnë diçka të përbashkët. Po të ishin natyrshme, ishin në një subjekt politikë dhe nuk ishin në dy subjekte politike. Prandaj, ta keni parasysh këtë çështje, unë do të jem prapë, mbani në mend, do të jem prapë këtu, po ju jo!

KRYETARI: Unë e kam një kërkesë nga ju, të nderuar deputetë, janë edhe 15 deputetë të lajmëruar për fjalë. Unë kisha thënë që t'i rrumbullakoni diskutimet në 3 minuta, më duken mjaftë janë. Jo, jo, ju vetë, jo unë t'ua imponoj. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Të nderuar kolegë deputetë, Sot u tha që është një ditë e veçantë. Vërtet është e veçantë për arsye se në vend që të ishim në një mbledhje solemne të Parlamentit të Kosovës për diçka të mirë, jemi në një mbledhje kur Qeveria, është e vërtetë ashtu qysh u tha edhe këtu, herë nga ata që ironizuan, herë nga ata që thanë tamam të vërtetën, po e rrëzon vetveten.

Kjo nuk është çudi, se e kemi ditë që në start dhe e kemi deklaruar. Nëse e mbani në mend mbledhjen e parë, kur u konstituua kjo qeveri, kemi deklaruar që vetën do ta rrëzojë sepse meriton një fat të tillë për arsye se është nisur me pabesi, është nisur me interesa të ngushta të dy udhëheqësve të dy partive dhe kështu ka përfunduar, domethënë është një logjikë normale.

Për ne është shumë normale kjo çka po ndodhë këtu për arsye se, paramendoni ju, para rënies së Qeverisë, fjalimi i kryeministrit është për studim. Për shkak se paska qenë Qeveri kaq e mirë, po u dashka të bie, për shkak se kanë punuar shkëlqyeshëm, po u dashka të bie, për shkak se partneriteti

ka qenë deri dje superlativ, po u dashka të bie. Dhe, po ashtu, edhe më ironizuese është kur në vend se t'i kërkohej falje qytetarit të Kosovës që ia ke sjellë krizën, tash donë të heqin përgjegjësinë që s'paska përgjegjësi këtu. Po, pse formohet Qeveria? Të marrë përgjegjësinë për interesat e shtetit, për interesat e qytetarit të vendit. Këtu janë rrezikuar skajshmërisht interesat e shtetit dhe mua më vjen keq, seriozisht, kur ka deputetë të cilët e dinë shumë mirë çka ka ndodhur gjatë këtyre 3 viteve. Asnjë prej atyre elementeve kapitale që i ka proklamuar kjo Qeveri, nuk kanë ndodhur, nuk kanë ndodhur, po e them, dhe po ashtu është keq kur nuk donë të shohin, së paku për një gabim të vetëm, nëse ka pasur kjo Qeveri, të thonë vetëm këtu kemi gabuar, po këtu del se paska punuar aq shkëlqyeshëm, sa po u dashka ta rrëzojë veten, se s'ka nevojë më për të. Kështu po del përfundimi.

Unë po ju them edhe diçka. Ka pasur pretendime nganjëherë për të hedhur hi syve opinionit, për të bërë do farë reformash dhe cilat kanë ndodhur prej tyre? Ka ndodhur reformatimi i çuditshëm, që ju e dini të gjithë, dhe paramendoni, në vend se të shkarkohen ministrat që është dashur të shkarkohen, janë shkarkuar do të pafajshëm, që as nuk e dinë pse. Seriozisht, ende opinionin nuk e di pse ka ndodhur dhe është keq pse ka ndodhur kështu, sepse është bërë ndërrimi me ata që e dinë pse kanë ardhur në Qeveri. Për fat të keq, shumë pak iu ka zgjatur, po, çka t'i bësh. Fati është, kur e ke një kryeministër në këtë nivel, edhe një qeverisje në këtë nivel.

Ju duhet t'i kërkonit falje popullit që po e çoni në zgjedhje të jashtëzakonshme, pas përcaktimit të datës së zgjedhjeve të parakohshme.

Ju duhet t'i kërkonit falje qytetarit të Kosovës që po e çoni në një moment, kur, duke e ngutur edhe KQZ-në, edhe mekanizmat që kanë për t'i vëzhguar zgjedhjet, ndoshta nesër partitë politike, për shkak të atyre që po dihet pse po përgatiten, të mos ua pranojnë rezultatin. Dhe, po e dini shumë mirë pse e keni bërë, sepse ju e keni bërë dhe është mirë, përfundimisht po ju them: nëse ka mbetur pak moral politik, nëse ka mbetur pak ndërgjegje, kërkonit së paku një falje të vogël qytetarëve të Kosovës për këtë çka e keni bërë për 3 vjet, e sidomos për mënyrën qysh po e bëni rrëzimin e Qeverisë sot. Është skandaloze, është më e keqja e mundshme për qytetarin e Kosovës.

Dhe, përfundimisht, duke iu thënë – lamtumirë, se më zor keni ta merrni Qeverinë, në pastë qytetarë të Kosovës që dinë të rezonojnë mirë dhe unë besoj se shumë mirë dinë të rezonojnë – ju të mos jeni më pjesë e qeverisjes sepse e keni shkatërruar shtetin, e keni shkatërruar vetveten pa u lyp kurrkush. Dhe këqyrni, bini sa më lehtë, në mënyrë që mos ta keni goditjen përfundimtare e të mos mund as në Parlament të jeni pjesë e Parlamentit. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Skender Hyseni.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi, Kryeministër, ministra, Të nderuar deputetë,

Më nxiti për të marrë fjalën një konstatim, përkatësisht formulimi i asaj që eseencialisht ka qenë prishje e koalicionit ose përfundim i një marrëveshjeje për koalicion dhe kualifikimi i saj si ikje pa mbulesë, u tha, as juridike, as politike.

Përfundimi i koalicionit ka mbulesë edhe juridike edhe politike, sepse ka ardhur pas dorëheqjes së presidentit në vijim të një interpretimi të Gjykatës Kushtetuese, se ka bërë shkelje kushtetuese dhe

Lidhja Demokratike e Kosovës s'ka bërë hiq më pak as më shumë se që e ka respektuar këtë interpretim të Gjykatës Kushtetuese dhe presidenti ka dhënë dorëheqje.

Pjesë e marrëveshjes politike për koalicion ka qenë edhe posti i presidentit. Prandaj, me dorëheqjen e presidentit, një pjesë esenciale e marrëveshjes për koalicion është zhvleftësuar dhe rrjedhimisht ka përfunduar.

Ndërkohë, janë shfrytëzuar vetëm një pjesë e instrumenteve kushtetuese për të plotësuar atë që duhej të plotësohej. Është emëruar ushtrues detyre i presidentit të Kosovës kryetari i Parlamentit.

(Ndërhyrje)

Po, është vendosur. Mirë. Kryeministri i Kosovës ka pasur në dispozicion instrument kushtetues për të plotësuar Qeverinë. Ka qenë zgjedhje e kryeministrit të mos e bëjë këtë dhe këtu nuk ka asgjë të keqe, është plotësisht e ligjshme dhe legjitime ta bëjë ose të mos e bëjë. Prandaj, të kualifikohet ndërprerja e koalicionit pas dëmtimit të pariparueshëm të marrëveshjes për koalicion si ikje pa mbulesë as juridike, as politike, nuk qëndron. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën! Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fillim nuk desha ta marr fare fjalën, por duke parë qëndrimet e disa deputetëve që po mundohen të paraqiten viktimë që në fillim të procesit, dëshiroj t'i them disa fjalë.

Së pari, kemi vendosur ta respektojmë qëndrimin e Grupit Parlamentar dhe do të votoj që ta ndërpresim mandatin e Qeverisë, natyrisht, edhe mandatin tonë, por kemi një qëllim shumë të madh. Edhe një herë po tregojmë që edhe Qeveria, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, por edhe parashtruesi i mocionit që ne para të gjithë interesave kemi interesin shtetëror.

Jam shumë i befasuar me disa deputetë që gjatë gjithë kohës nuk kanë lënë asgjë pa thënë për Qeverinë, asgjë pa thënë për ne, kurse sot po u tregojnë qytetarëve të Kosovës që janë të pafuqishëm, janë të pakoncentruar dhe nuk janë të gatshëm, që çdoherë kanë kërkuar zgjedhje të jashtëzakonshme, sot nuk janë të gatshëm, edhe pse kjo krizë institucionale nuk është krijuar nga ne, kemi pasur dëshirë të punojmë së paku edhe 1 vit dhe ta përfundojmë mandatin me të gjitha ato suksese që kemi arritur.

Është për çudi që edhe kjo shkelje kushtetuese, edhe këto lojërat tjera që janë bërë, nuk i ka bërë Partia Demokratike e Kosovës, s'i kemi bërë ne. Ne kemi një koncept shumë të qartë, kemi angazhime shumë të sinqerta para vetes, por sot po iu tregojmë që, nëse është çështja e Kosovës në pyetje, çdoherë do të votojmë edhe kundër vetvetes, vetëm për ta nxjerrë shtetin nga kjo krizë institucionale.

Ishte edhe një supozim se e kanë gjetur momentin më të rëndësishëm për të votuar. Jo, absolut jo! Dhe, për dijeni, ne zgjedhje kemi pasur hiq më parë se para një viti dhe jemi matur, shumë mirë jemi matur. Kemi qenë të gjithë këtu. Bile, bile jemi bërë edhe bashkë, por ju kemi treguar se çka janë zgjedhjet demokratike dhe si fiton partia e cila ka vizion sepse e mbështetin qytetarët e Kosovës.

Krejt në fund, edhe sot po ju themi: ne nuk po shkojmë me dëshirë dhe nuk kemi shkuar me dëshirë. Të gjithë po deklarohe mi se po duam ta rrëzojmë veten, por po e dimë sigurt që edhe nga Qeveria, edhe nga Kuvendi po dalim të palënduar. Të lënduar do të dalin ata të cilët kanë shkelur Kushtetutën, kanë dezinformuar qytetarët e Kosovës se janë të gatshëm në çdo moment të udhëheqin Kosovën dhe sot po deklarohen që sot se kanë për t'i humbur zgjedhjet dhe po paraqiten në rolin e viktimës.

Prandaj, edhe një herë them se unë do të votoj dhe kam vetëm një qëllim: që interesat shtetërore janë para së gjithash interesa të Partisë Demokratike të Kosovës dhe, natyrisht, të dyzet deputetëve që e kanë nënshkruar mocionin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryetar,
Zotëri kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Deputetë të respektuar,
Do të përpiqem që asnjë fjalë që është thënë deri më tash mos ta përsëris, sepse kjo është pasojë që kah fundi, pra, asisoj edhe të imponohet.

Kam dëshirë ta theksoj këtë poentë. Shumëkush me tendencë e ka quajtur edhe më parë, edhe tash - koalicion i panatyrshëm. Unë e kam në libër, kaq po e zëmë. Uniteti i kontradiktave. S'ka unitet pa kontradikta, por kjo është kjo, partitë politike e tjera. Mirëpo, pse nuk ka funksionuar, është problem tjetër.

Në këtë Kuvend kam pasur nderin e kënaqësinë ta ngrejë një numër të madh të mocioneve gojore dhe shkrimore, gjithmonë me qëllimin më të mirë, jo për ta qortuar ekzekutivin, përkundrazi, për ta orientuar në disa pika neuralgjike të cilat ishin, janë e mbeten shumë të nevojshme e të justifikueshme për t'u zgjidhur, se si do të duhej për t'u zgjidhur. E në këtë rast, do t'i poentoj vetëm disa prej tyre, të cilat, dorën në zemër, me sinqeritet, po të kishte qenë Qeveria më efikase, më efëçiente, të gjitha do t'i kishte zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme.

Dhe, do ta them edhe këtë, që në fillim – në qoftë se ndokush do të kërkojë votëbesim nga votuesi që këto detyra do t'i prezantojë me bindje se do t'i kryejë dhe duhet t'i kryejë në të ardhmen Qeveria e ardhshme. Ndër të tjera, këto po zëmë: Sistemi i pagave, hiq më larg se sot në gazetë, drejtori i Postës e merr pagën 10.000 euro në muaj, jo në saje të punës, por të pozitës monopoliste në treg, që është turp dhe mëkat i madh, ju lutem, në sistemin e pagave që sa e sa. Ose, kryepensionisti i Kosovës e merr 10.000 euro, ndërsa pensionisti i ngratë, i mjerë, i nëpërkëmbur i merr 50 euro, 60 euro. Konkursët, ju lutem, nuk përfilllet instituti i konkursit që është parakusht për ligjshmërinë. Me dhjetëra, e dhjetëra shembuj do t'i kisha dhënë.

Qe, po e zëmë, e kam respektin për ministrin e Arsimit. Para 40 vjetëve Kosova ka pasur kuadro, po e zëmë, rektorë, me renome rajonale, sot po e zëmë e emërojmë rektor një të jashtëm dhe e superfavorizojmë, kur ne kemi me dhjetëra e dhjetëra njerëz shumë kompetentë, po zëmë, pse, pse asisoj. Shumë operatorë, unë e di numrin ekonomik, të palicencuar marrin tender, kryejnë punë. Dihet si i kryejnë punët. Punë jo kualitative, punë shkel e shko. Prodhuesi vendor është krejtësisht i pambrojtur. Konsumatori... Kolege, ju lutem! ...Konsumatori vendor, secili prej tyre, po e zëmë, krejtësisht është i pambrojtur, me artikuj ushqimorë të cilësisë më të ulët, me surrogate. Sistemi bankar është tepër i disfavorshëm për bizneset e vogla dhe të mesme. Kamatat, normat interesore janë më të lartat në Evropë, ju lutem!

KRYETARI: Deputet, të lutem, përmbaju rendit të ditës!

RIZA SMAKA: Gjyqësori, administrativi, nuk zbatohen, nuk janë zbatuar as aktvendimet e formës së prerë, me qindra. Kanë mund të ekzekutohen të gjitha ato.

Sa i përket ndërtimeve ilegale, me pak punë ka mund të evitohen... Është ngulfatur krejt Prishtina, krejt Kosova me ndërtime ilegale. Toka pjellore, 1.000 hektarë tokë pjellore në vjet uzurpohen me ndërtime ilegale.

Përfundimisht, kolegë të nderuar, nuk është rasti për t'i numëruar se Qeveria ka bërë punë, ka treguar edhe suksese, natyrisht, por në këtë rast në kontekstin e mocionit, them, do të isha koncentruar edhe në dispozitën e nenit 82 paragrafi 2, ku është dhënë fakultativisht shpërndarja e Kuvendit, jo obligativisht. Kuvendi ishte funksional, ishte në nivelin e detyrës. Duhet medituuar se duhet apo jo të shpërndahet Kuvendi i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Në historinë parlamentare të Kosovës, Hashim Thaçi do të shënohet si kryeministër të cilin e rrëzoi partia e vet me vota të veta.

Do të mbahet në mend, gjithashtu, si kryeministër i cili e shfrytëzoi Ditën e Pavarësisë për të keqpërdorë rreth 1.000.000 euro dhe i cili nuk dha llogari para këtij Kuvendi se çka ndodhi me ato para.

Do të mbahet në mend, gjithashtu, si kryeministër i cili në ditën e fundit të të qenit kryeministër i Kosovës iu thotë qytetarëve dhe deputetëve - ka ardhur koha të jemi në shërbim të vendit dhe jo të interesave personale. A mos është pak vonë, kryeministër?

Tri vite më parë, nga kjo foltore, kryeministri Thaçi në ballafaqim me deputetë dha premtime, si në vijim: Unë ju siguroj se në afate kohore prej 9 deri në 12 muaj në Kosovë do të ketë energji elektrike 24 orë për të gjithë qytetarët e vendit dhe do të rikthejmë rrjedhën e buxhetit prej KEK-ut në buxhetin e Kosovës dhe jo siç ishte deri më sot. Ky premtim u dha nga ju personalisht në mars të vitit 2008. A e dini cila është gjendja sot? Në vend të kësaj, iu dhatë mbi 200.000.000 euro për import të energjisë elektrike, para këto të cilat do të shkonin shumë mirë në sektorët si bujqësia, shëndetësia, arsimi dhe mirëqenia. Dhe, ju nuk e mbajtët fjalën.

Thatë se do të rrisim pensionet. Madje nënshkruat edhe një memorandum mirëkuptimi. Sot kemi edhe parti të pensionistëve të cilët është dashur që të themelojnë një të tillë nga mospërfillja juaj. Do të rrisim pagat! A e dini sa është paga mesatare sot në Kosovë e një polici, një mjeku, një arsimtari dhe një shërbyesi civil?

Në të njëjtën foltore keni thënë - ne kemi përgatitur planin i cili do t'u mundësojë bizneseve në Kosovë që të kenë kredi afatgjata dhe me interesa të ulëta. Në Kosovë sot vazhdojnë të jenë kreditë me kamatat më të larta në rajon.

Kosovën do ta bëjmë silicon valley. A e dini çka është silicon valley dhe a e keni ditur atëherë kur e keni dhënë premtimin.

Keni deklaruar se do të angazhohemi personalisht që bashkatdhetarët tanë të kenë lehtësira. A e dini sa paguajnë këta njerëz të diasporës për bileta, një biletë aeroplani, sa është çmimi i saj sot, tri vite pas pavarësisë.

Nën udhëheqjen e juaj, zoti Thaçi, sot Kosova është vendi më i varfër në Evropë, me papunësinë më të lartë, me korrupsionin më të lartë dhe me shkeljen e lirisë së medias.

Dhe ashtu, siç kam thënë edhe shumë herë më parë, kjo nuk është për të qeshur, kryeministër. Ju duhet të qani dhe të kërkonit falje para qytetarëve të Kosovës. Sepse, ju përcjellin dy raporte të turpshme, ai i “Transparency International” dhe i “Reporterëve pa kufij” në ditët e fundit të qeverisjes tuaj.

Duke marrë parasysh se ju veç filluat fushatën zgjedhore kohë më parë, me taksat e qytetarëve shumë të varfër të Kosovës, nga pozita e kryeministrit në ikje, ne sot i ftojmë qytetarët e vendit që të kujtojnë të gjitha këto premtime të cilat ju nuk i mbajtët dhe në fakt i rrënuat. Sepse, jeni përgjegjës, bashkë edhe me disa parti tjera satelitë që u mohuat, të cilat sot po mundohen tua shkurtojnë vuajtjet, për goditje ndaj dëshirës së popullit të Kosovës për liberalizim të vizave dhe përpjekje për anëtarësim. Po ju rikujtoj se nga varfëria dhe tendenca për të ikur nga Kosova, nën udhëheqjen e juaj ndodhi edhe “Tragjedia e Tisës”.

Dhe, krejt për fund, krejt për fund, kjo i referohet konceptit mesjetar të qeverisjes suaj. Nga zyrtarë të lartë të Qeverisë Thaçi u deklarua se gruaja konsiderohet si e padenjë për debat, si e pabarabartë dhe unë jam fort e bindur që gratë e Kosovës do të dëshmojnë të kundërtën dhe do të tregojnë që ne nuk do të lejojmë asnjëherë që të udhëhiqemi nga njerëz me koncepte mesjetare, njerëz të cilët njëherë udhëheqin rreth 3 vite dhe të cilët u deshtë të kërkojnë votat e të gjithë deputetëve për të votuar mosbesim ndaj tyre, të cilët madje edhe bënë presion ndaj deputetëve të caktuar të votohet mosbesim ndaj tyre dhe të cilët kurrë më, kurrë më nuk do të kthehen në qeveri.

Prandaj, ky është lajmi më i mirë për qytetarët e Kosovës. Sot është një ditë e veçantë dhe sot kemi marrë lajme shumë të mira, kryeministër, sepse ju erdhi fundi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Gani Buçinca e ka fjalën!

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti president me detyrë i Republikës së Kosovës,

Zoti kryeparlamentar,

Ju falënderoj edhe ju kabinet qeveritar dhe i nderuari zoti kryeministër,

Me kënaqësinë më të madhe e kam nënshkruar mocionin e mosbesimit për arsye se që nga momenti kur e kam marrë lajmin për braktisjen e institucioneve të Kosovës nga partneri i koalicionit, që në atë moment kam qenë i bindur se politikën duhet kthyer qytetarit të Kosovës, për arsye se në vitin 2007 qytetarët e Kosovës kishin bërë një zgjedhje politike për drejtimet e vendit dhe ajo zgjedhje politike, me dhënien e dorëheqjes së presidentit kishte humbur kuptimin e vet. Ishte plotësisht në përputhje me bindjet e mia politike, me parimet dhe kulturën time demokratike politike.

Sidoqoftë, sikur të ishte vendimi i partisë sot ndryshe, unë nuk do të votoja mocionin, prapë do të votoja sipas asaj çka voton shumica e subjektit tim politik, për arsye se Partia Demokratike ka një

marrëveshje të brendshme, ka një disiplinë partiake, ka parime, norma, ka një vizion dhe koncept të qëndrueshëm të njerëzve që e përbëjnë atë dhe që e udhëheqin atë koncept dhe atë vizion.

Për këtë arsye, qytetarit të Kosovës i kisha thënë se nuk do të duhej të hezitojë kurrë kur voton për Partinë Demokratike, se atë që e thotë, edhe e bën.

Tani po kthehem të shpjegoj para opinionit vetëm një rrethanë pse duhet shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme. Sikur të kishte braktisur koalicionin partneri, vetëm një ditë para dekretimit të datës së zgjedhjeve, gjithçka do të ishte në rregull, për arsye se do të ekzistonte mundësi edhe kushtetuese edhe ligjore që Partia Demokratike të hynte në aranzhmane me ndonjë parti tjetër, që të bënte rikonstruimin e Qeverisë deri në zgjedhjet e 13 shkurtit. Mirëpo, meqë presidenti e kishte dekretuar datën, çdo marrëveshje, çdo aranzhuan tjetër ishte i pakuptimtë dhe i pa mundur në një situatë kur ishte shpallur data e zgjedhjeve. Për këtë arsye, ikja, braktisja, tradhtia që i ka bërë Lidhja Demokratike e Kosovës koalicionit qeverisës ishte e paimagjinueshme dhe nuk ishte në asnjë praktikë në jetën politike të asnjë vendi demokratik. Për të kuptuar qytetari i Kosovës më mirë, do të jap një shembull në mënyrë figurative. Kjo i bie njësoj sikur kur dy miq bëjnë një krushqi dhe njëri duhet t'ia japë çikën për djalë mikut, e ndajnë vaden, e caktojnë dasmën mirëpo ky tash – daja që ka për t'ia marrë vajzën atij mikut, thotë – unë nuk do të shkoj ta marrë me kerr të kuq, siç e do zakoni, por unë do t'ia grabiti atij vajzën. Në mënyrë figurative i bie kështu. LDK-ja ka dashur të jetë opozitë gjashtë muaj dhe t'i harrojë edhe sukseset që i ka pasur me Partinë Demokratike për 3 vjet, dhe shtrohet pyetja - pse ka ndodhur kështu? Ka ndodhur kështu për arsye se një krizë personale, të ish presidentit, dhe krizën partiake që e ka pasur LDK-ja brenda-përbrenda, ka dashur ta shndërrojë në një krizë nacionale politike. Kjo është e vërteta. Dhe çka ka ndodhur tani, pse e kam nënshkruar unë mocionin? Për arsye se në Kosovë duhet t'i kthehet politika qytetarit, të vendos qytetari i Kosovës që të japë zgjedhjen me votën e vet e jo ne të flasim për liderë të caktuar, për parti të caktuar, për krizat që i kanë brenda partisë. Dhe sot dëgjova këtu se duhet me prit ndoshta Partia Demokratike me i bë zgjedhjet dhe dikush këtu nga deputetët të ndërrojë statusin civil, ose të divorcohet ose të martohet. Domethënë, ne nuk mundemi, nuk mundemi si parti politike t'i kemi në përgjegjësi fatet personale individuale, qofshin të akterëve politikë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetja Besa Gaxherri, e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,

Kolegë deputetë,

Realisht, unë nuk e kam pasur sot ndërmend të marr fjalën, për arsye se kjo çështja e krizës institucionale, politike, unë kisha thënë edhe krizë e etikës politike në Kosovë, gati është konsumuar që një muaj.

Megjithatë, rendi kushtetues dhe i Rregullores së Kuvendit e procedoi këtë mocion dhe jemi këtu. Njëkohësisht, tradita jonë shqiptare në këtë rast dardane është që mos t'i bie njeriut kur përdhohet. Por, realisht këtij debati, këtë debat e nxitët më shumë ju mazhuranca dhe, në veçanti ju, zoti kryeministër.

Në qoftë se ju dy subjektet politike gjeni forcën morale dhe etikën politike, ju dy forcat të cilat ia shkaktuat të gjitha ato të këqija vendit, e debatoni sot, atëherë natyrisht se opozitës, në këtë rast Lidhjes Demokratike të Dardanisë i imponohet faktikisht të flasë, sepse nuk kemi çka të flasim.

Shumë deputetë këtu e theksuan gjendjen reale për 3 vjet, ndërsa LDD-ja konsideron se kriza është, ka qenë realisht, me lidhjen e këtij koalicioni dhe që nga dita e parë deri sot Kosova ka pasur krizë.

Por, në fjalimin tuaj, zoti kryeministër, e theksuat ose po them kështu: përveç premtimeve tjera që i keni dhënë, moton e keni pasur “Krenohu me Kosovën”. Dhe, ju pyes, zoti kryeministër, a duhet Kosova të krenohet sot me ju, apo duhet të turpërohet?!

LDK-ja ka pas thënë: ky koalicion është për shtetin, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës dezertoi, e la shtetin.

Ku jeni sot dhe ku na keni sjellë sot? Për mua është e papranueshme edhe nga disa deputetë nga opozita që vërtet me të drejtë kanë kërkuar që kjo qeveri duhet të shkojë, sot donë ta shfrytëzojnë momentin secila parti politike të thotë, nuk duhet të shkojë, nuk do ta votoj e tjera. Kjo qeveri, kolegë të nderuar, nuk është dashur të na marrë kaq shumë kohë për të debatuar sot. Është dashur vetëm përfaqësuesit e grupeve parlamentare ta kenë fjalën dhe shumë shpejt ta votojmë dhe të shkojmë tutje se s’kemi çfarë të presim.

Zoti kryetar, shembull, unë i ndjeva disa deputetë që, fundi i fundit këto gjëra ndodhin në shtetet demokratike, a? Por, vërtet, ky nuk është shembull demokratik. Shembull demokracie është kur pushtetet janë realisht të ndara, të pandikuara. Kur Qeveria si sot, për shembull, kërkon besimin, së paku nga deputetët e vet dhe deputetët e vet gjejnë fuqinë e besimit të qytetarëve dhe i thonë jo, duhet të shkosh se keni gabuar. Po, kjo te ne, nuk ndodh. Nuk ndodh sepse Kosova është sui-generis. Edhe vetë shkuarja e Qeverisë është sui-generis.

Megjithatë, edhe unë personalisht dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë do të votojmë dhe të lus, zoti kryetar, sa më shpejt ta hedhësh në votim që kjo Qeveri të shkojë. Të shkojë dhe t’iu hapim rrugë qytetarëve të vendit, me një vizion ndryshe, me një alternativë ndryshe dhe, fundi i fundit, edhe me këtë të keqe që ka ndodhur duhet të marrim mësim të gjithë dhe t’i thërrasim ndërgjegjes që këto gjëra çfarë kanë ndodhur, mos të përsëriten më.

Unë nuk i radhita, sepse janë folur kohë pas kohe të metat, por pasi jeni këtu, mos ta harroj një, se s’kam pasur mundësi ta them për Ministrinë e Arsimit. Zoti ministër, nuk ka shkelje më të rëndë se të themelohet një universitet kaq i mirëseardhur, siç është Universiteti i Prizrenit dhe mos të vini as formalisht ta pyetni Kuvendin e Kosovës, që jeni të obliguar me ligj e me Kushtetutë. Dhe unë sot propozoj këtu, dhe uroj edhe punën që e ka filluar jashtëligjshëm, ky universitet. Megjithatë, uroj që në Kuvendin tjetër ta votojmë dhe ta emërojmë, t’ia japim emrin këtij universiteti, emrin e patriotit kombëtar të zotit Ukshin Hoti. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën! Po, në fund desha ta jap fjalën, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Parlamentit,

Të nderuar, deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë edhe në takimin e kaluar, apo në mbledhjen e kaluar të Parlamentit të Kosovës kam deklaruar qartë se pozicionimeve me karakter elektoral nuk do t’u përgjigjem në Parlament sepse nuk dëshiroj që Parlamenti të jetë betejë elektorale, prandaj edhe jam i kursyer edhe sot që ta respektoj atë parim dhe atë zotim të dhënë para juve dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim dëshiroj të theksoj se në disa deklarime që u dëgjuan këtu, përsëri do ta respektoj atë parim që të kursej, të kursej nga ngatërresat e shumta që po paraqiten në drejtim të gabuar, sepse a duhet të krenohet apo të turpërohet Kosova, flasin vetë qytetarët e Kosovës dhe jo zëri i një deputeti. Se si trajtohet komuniteti i biznesit në Kosovë, ka folur dhe flet vetë komuniteti i biznesit dhe qytetarët e Kosovës janë të bindur, veçanërisht ai trajtimi i juaj, që partia juaj, Donikë, i bën biznesit të Kosovës dhe kjo ka pasur mundësi të konfirmohet në 3 ditët e fundit dhe opinionin e di krejt. Në anën tjetër, gjithmonë duke ju thirrur, gjithmonë duke ju thirrur që gjithmonë të kemi Kosovën si interes, të dalim mbi interesat partiake, gjithashtu dëshiroj të theksoj se këtu nuk kemi të bëjmë me tradhti apo mos tradhti. Unë me gjithë njerëzit që kam punuar 3 vite, pa dallime partiake, si kryeministër i Kosovës ndihem krenar me ata njerëz që kam punuar. Ndhem shumë i përgjegjshëm dhe kudo që të jem, prej zëvendëskryeministrit, ministrave të LDK-së, të PDK-së, të gjitha komuniteteve, kudo që janë me mua në krah apo përballë, janë miq të mi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Zylfije Hundozi, e ka fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk do t'i flas dhe përsëris ato çka u thanë deri më tash prej deputetëve të Kuvendit të Kosovës, se shumë u fol për punën e kësaj qeverie, po unë, pas gjithë këtyre fjalëve, erdha deri te një konkludim, se pse kemi ardhur ne sot në këtë situatë për ta debatuar këtë mocion.

Para dy muajve në Kuvendin e Kosovës ka qenë Edward Kukan në një vizitë në Parlamentin tonë dhe duke iu referuar asaj të famshme në Raportin e progresit që Kuvendit të Kosovës agjendën po ia bën Qeveria, e pyeti kryetarin e Parlamentit se si po përballlet ky me një personalitet kaq të fortë, siç është kryeministri. Sot unë po ju pyes, a jeni ju personalitet i fortë, a jeni ju lideri shpirtëror i Kosovës, a jeni ju George Washingtoni? Po! Sipas kësaj që bëtë sot, unë e them që jo.

Grupi juaj parlamentar kërkoi që të bie kjo qeveri. Ky është rezultat i paaftësisë tuaj që të gjeni rrugë të reja, zgjidhje të reja që ta çoni mandatin tuaj deri në fund. A ka dështim më të madh se kryeministri të dalë në foltore dhe të thotë që po çon dorë prej qeverisjes së vet! Të kishit qenë ju personalitet më i fortë dhe personalitet që ka lidhshëm, a do të ishim ne sot këtu? Me siguri se jo.

Këto vlerësime nuk janë vetëm të miat. Populli është radari më i mirë që di se kujt duhet t'i lejohej që ta udhëheqë. Dhe, me siguri se qysh tash në mendje të tyre po krijohet vizioni i një lideri të ri, që do të na lirojë nga varfëria dhe do të na çojë drejt integriteteve evropiane dhe NATO-s. Mendoj se këto fjalë ndoshta do t'i analizoni mirë para se të kërkonit të bëheni prapë kryeministër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli!

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryetar i Kosovës!

Kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Për t'i rënë shkurt, këtu nuk po shtrohet problemi i votëbesimit sipas PDK-së, por për ndërprerjen e krizës, siç po thuhet, institucionale.

Për mendimin tim, nuk është krizë e krejt institucioneve, se institucione ka shumë, por është krizë qeveritare.

Pra, me këtë mocion mosbesimi po pretendohet të dilet nga kriza qeveritare. Kjo, në shikim të parë, për mendimin tim, në sipërfaqe duket edhe logjike, edhe simpatike, por gjithmonë, për

mendimin tim, kjo nuk është e menduar mirë, sepse duke u përpjekur që sa më parë të dalë Qeveria, domethënë një institucion nga kriza, e këtë ne e dimë, është edhe në agjendat ndërkombëtare, që sa më shpejt të fillojnë bisedimet me Serbinë, në fakt po dëmtohet rënd një institucion tjetër shumë i rëndësishëm - ai i zgjedhjeve në një vend, ku edhe ashtu institucioni i zgjedhjeve ka kaluar me shumë vështirësi dhe me defektet që i dimë.

Në rast se zgjedhjet mbahen të jashtëzakonshme, koha do të jetë e shkurtër që ato të monitorohen dhe vëzhgohen nga faktorët që e kanë vëzhguar deri më tash procesin zgjedhor në Kosovë. Pra, këtu, megjithëse shpresat për të dalë nga kriza po mbështeten në zgjedhje të reja, por a do të jenë ato të tilla që premtojnë stabilitet, kjo është krejt diçka tjetër. Dhe ngutja për t'i bërë ato të jashtëzakonshme ulë shansin për një qeveri stabile. Domethënë, unë pretendoj që është, ka qenë më e udhës që të mendohet çka edhe pas zgjedhjeve, sepse nuk do të thotë se nëse mbajmë zgjedhje do të vjen një udhëheqje që vërtet do ta udhëheqë vendin dhe jo që do ta sundojë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi edhe 7 deputetë të lajmëruar. Unë ju kisha lutur që t'i rrumbullakoni diskutimet në 3 minuta, se mendoj janë të mjaftueshme. Fjalën ia kisha dhënë deputetit Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Parlamentit, Krasniqi, Zoti kryeministër Hashim Thaçi, Kolegë deputetë, Mendoj që s'është vendi sot që të flasim shumë me emocione, ndonëse njerëzit i respektoj, nuk reagojnë njësoj në të njëjtat situata.

Ne kemi një mocion mosbesimi për Qeverinë dhe sot, natyrisht, do ta marrim një vendim rreth kësaj.

Nuk është mirë që ky akt konkret, që është ligjor, është kushtetues, të shfrytëzohet për vlerësime edhe kuturu edhe të shpejta, edhe të raporteve, edhe të ndodhive të kaluara dhe të pritshme.

Unë vetëm dua t'i radhis tri-katër konstatime sa më neutralisht që të jetë e mundur, në mënyrë që edhe ne këtu t'i rikujtojmë, por edhe ata që na shikojnë t'i kenë të qarta, mos të kenë mjegullina dhe dykuptimësi.

Koalicioni PDK-LDK është krijuar në mes dy partive politike, natyrisht, me kurorëzimin dhe kurorën e dy udhëheqësve të tyre – të partive që janë Hashim Thaçi dhe Fatmir Sejdiu. Është krijuar sigurisht për interesa politike, sepse ndryshe nuk krijohen koalicionet dhe është deklaruar natyrisht si koalicion për shtetin. Padyshim se ekzistojnë dy vjet shtetndërtim dhe ne edhe po deshëm me emocione t'i mohojmë ose mos t'i mohojmë, këto kanë ndodhur. Dhe, është historia që do të merret me të, jo ne sot.

Ky koalicion ka rënë ditën kur Fatmir Sejdiu ka dhënë dorëheqje nga kryetari i shtetit. Nuk do ta elaboroj më tutje, sepse që të nesërmen, detyrën me Kushtetutë e ka marrë kryetari i Parlamentit, që i takon, dhe është ditur që atë ditë që për 6 muaj do të ketë zgjedhje të reja. S'po them kurrgjë të re, por duhet të merren në evidencë këto punë. Dhe të gjitha partitë kanë reaguar në mënyrë të rezondeta, a – me arsyen shtetërore që të merren vesh, ta caktojnë një ditë të zgjedhjeve. Ajo ditë është caktuar.

Çka do të thotë kjo? Sot kemi një mocion për Qeverinë. Çfarë do të jetë rezultati i këtij mocioni sot, kjo nuk është mbledhje ku ka për t'u vlerësuar puna e Qeverisë as mirë, as keq, as e koalicionit, as e PDK-së, as e LDK-së. Prandaj, nuk jam prej atyre që e nxjerr gjuhën e gjatë sot e të flas as mirë për dikë, as keq për dikë.

Çka do të rezultojë nga votimi sot? Nga votimi sot do të rezultojë vetëm kjo: A do të kemi zgjedhje në dhjetor apo në fror? Dhe, asgjë më shumë, dhe asgjë më pak. Ky është rezultati! Pse? Sepse, Qeveria, thashë, Qeveria e tillë qysh është e paplotësuar ose e plotësuar, do ta kryej punën. Është në dorëheqje që nga dita kur ushtruesi i detyrës së kryetarit e ka dekretuar një datë të zgjedhjeve.

Ne e dimë që do të shkojmë në zgjedhje. Nga ajo ditë, Qeveria është në dorëheqje, faktikisht.

Dhe sot, nëse i votojmë mocion mosbesimi Qeverisë, kjo Qeveri është prapë në dorëheqje dhe do ta kryejë punën detyrimisht deri në ditën kur formohet tjetra dhe të jetë e qartë kjo për deputetët, për ne, për Qeverinë, për Kuvendin dhe për opinionin.

(Ndërhyrje, reagim)

Unë jam duke folur para opinionit dhe para Kuvendit. Unë nuk e kam njet sensibilitetet e kurrkujt... dhe, e thashë, s'do ta zgjas gjuhën - as ta lëvdoj, as ta kritikoj askënd dhe i mbetem kësaj me neutralitetin e fundit. Unë po flas evidenca. Pra, a votohet sot a s'votohet, mocioni e ka veç një punë: a do të jenë zgjedhjet e detyruara me këtë vendim, nëse shpërbëhet Parlamenti, natyrisht, a do të jenë në fror apo në dhjetor. Konsekuenca tjera në udhëheqje, në detyrime, nuk ka. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismail Kurteshi! Mundësisht, shkurt Ismail!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Deputetë të nderuar,

Kabinet i vetëdorëzuar qeveritar,

Ditëve të fundit, partnerët e koalicionit kudo që arrijnë, e akuzojnë njëri-tjetrin për krizën e shkaktuar institucionale. Të njëjtit nuk e lënë pa e paraqitur veten si shpëtimtar të vendit nga kjo situatë, të cilën, natyrisht që ata e kanë krijuar vetë. Thua se qytetarët, të cilët janë lodhur me këtë qeverisje, nuk e dinë se këtë krizë të kurdisur e kanë shkaktuar vetë partnerët e koalicionit.

Qytetarët po ashtu e dinë se kjo krizë është shkaktuar nga të lartpërmendurit sepse ata kanë vlerësuar se është moment i volitshëm për qeveritarët aktual ta grabisin edhe një mandat për t'i rrumbullakuar projektet e filluara, si: bisedimet me Serbinë, bisedime këto të cilat i nevojiten Serbisë për të vazhduar me procedurat e integritetit në Bashkimin Evropian, të vazhdohet me privatizimin e pronave publike nga i cili as Kosova, as qytetarët e saj nuk kanë fituar asgjë, të vazhdohet me deklaratimet për gjoja zero tolerancë, për korrupsionin i cili po lulëzon nga dita në ditë, të vazhdohet me hartimin e strategjisë si ajo për Kosovën veriore, e cila është pluhurosur diku në zyrat e kësaj Qeverie, të vazhdohen me rritjen e papunësisë, me decentralizimin i cili po shkon drejt autonomisë, me premtimet për pensionerët, mësimdhënësit, punëtorët e shëndetësisë e tjera. Pra, të vazhdohet me thellimin e krizës në vend.

Sot unë kam vendosur të abstenoj, sepse kjo qeveri nuk e meriton përkrahjen, kurse nuk ka nevojë të votoj për rënien e saj, sepse ajo po rrëzohet vet.

Qeveria po bie jo për ta nxjerrë vendin nga kriza, por për të bërë zgjedhje të shpejta të cilat mund ta çojnë vendin edhe në një krizë më të thellë. Prandaj, ngutjet nuk janë të mira sepse populli shpesh thotë se po qe se u ngute shumë, mund ta thyesh qafën. Mirëpo, është me rëndësi se populli po e heq qafe një qeveri e cila është dashur të shkojë që në mars të vitit 2008.

E mira e kësaj qeverie është se ajo më në fund e ka pranuar publikisht se nuk është e aftë ta udhëheq vendin. Jam i sigurt se këtë fakt do ta mbajnë mend qytetarët kur të shkojnë te kutitë e votimeve dhe nuk do të lejojnë që të votojnë për formacione të cilat nuk do të jenë në gjendje ta çojnë mandatin deri në fund, ashtu siç duhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë jam dakord! Mirëpo, po i ftoj deputetët që janë këtu pari le të kthehen dhe deri të kthehen ata, fjalën po ia jap deputetit Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë që për çdo çështje të ngritur të debatohet deri në detajin e fundit. Natyrisht se kur ka debate, ka edhe polemika. Dua të besoj se për të gjithë ne polemikat duhet kuptuar si konfrontim idesh për zgjidhjen më të mirë të problemeve, e në asnjë mënyrë që polemika të kuptohet si diçka tjetër.

Çdo çështje që ngrihet, siç është mocioni i Grupit Parlamentar të AKR-së, së pari duhet të analizohet mirë me qëllim që të kemi një zgjidhje të pranishme dhe konform Kushtetutës.

Mocioni është i qartë dhe nuk ka dilema as për ne, as për qytetarët se ne sot votojmë për të dalë nga kriza institucionale pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ku ka konstatuar shkelje serioze të Kushtetutës nga ana e presidentit dhe pas tërheqjes së LDK-së nga koalicioni qeveritar.

I kuptoj të gjitha shqetësimet e disa deputetëve të një pjese të opozitës që po i ngrisin sot këtu. Por, po harrojnë se kjo qeveri, me kryeministrin Thaçi, ka bërë punë të mëdha për Kosovën, së bashku me këta deputetë bënë shpalljen e pavarësisë së Kosovës, që ka qenë synim dhe qëllim i çdo qytetari të Kosovës, se me këtë qeveri kemi arritur progres pothuaj se në të gjithë sektorët. Kemi investime kapitale në çdo cep të Kosovës. Kemi rritje ekonomike dhe zhvillim ekonomik. Do të vazhdoj me një thënie - ai që mohon çdo gjë, nuk thotë asgjë.

Por, mos harroni se qytetarët e Kosovës nuk mendojnë siç mendojnë disa deputetë këtu, që vazhdimisht kanë përdorur foltoren për të akuzuar dhe thënë të pa vërtetën. Qytetari ynë, të gjitha të arriturat e Qeverisë Thaçi i ndien, i sheh dhe i prek, i kanë besuar dhe do t'i besojnë edhe në të ardhmen. Qytetarët i kanë besuar George Washingtonit të Kosovës për ta shpallur Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik dhe do t'i besojnë prapë për ta çuar Kosovën në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja... Veç po ju njoftoj se, ju e dini, nëse e keni lexuar Rregulloren, se rendin e fjalëve për diskutim e bën kryetari i Kuvendit. Mendoj se këtë e keni parasysh sepse deputetë, ju që e keni lexuar Rregulloren... Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

Unë e di, zoti kryetar, që gjithmonë ju jeni ai që e zgjedhni, por nuk mund të ndodhë që bash të dikush gjithmonë mos ta marrë fjalën. Edhe unë gjithmonë e marr fjalën pas orës 17, por sot për mua nuk është problem. Nuk ka problem!

Unë jam prej atyre që kam nënshkruar këtë mocion për mosbesim të Qeverisë dhe nuk kam marrë parasysh veprimin e Qeverisë dhe punën deri më tani dhe mendoj se duhet të votohet për mocionin për disa argumente.

Ne jemi në krizë institucionale, a është krizë e qeverisjes apo e institucioneve, në qoftë se nuk është sot, ajo bëhet nesër. Gjithashtu, nuk kemi aprovuar buxhetin dhe me siguri mund të ndodh, në qoftë se e lëmë të zgjasë këtë situatë, vjen edhe kriza financiare.

Unë i kam bërë pyetje vetes, cilat janë argumentet pro për të mbajtur zgjedhje të jashtëzakonshme menjëherë, cilat janë kundër asaj, veprime negative dhe çka do të ndodhë në qoftë se mbahen zgjedhje edhe pas 4 ose 5 muaj.

Për shkak të situatës të cilën e kemi në shoqëri, atë duhet theksuar dhe bash kam iniciuar të them edhe për shkak të veprimit edhe të kryetarit, e kemi demokracinë e brishtë jo vetëm në parti të politike, por edhe në shoqëri në tërësi dhe kjo po reflektohet edhe në veprimin institucional. Kjo do të thotë që ende vuajmë edhe si shoqëri të kemi liderë dhe zakonisht lideri edhe në parti edhe në institucione e trason rrugën ku duhet të shkojmë. Të gjithë po thonë se duhet shkua kah Evropa për ta inkuadruar vendin në Bashkësinë Evropiane, por rrugët janë të shumta.

Unë nuk dua ta zgjas, po e përfundoj këtë vlerësimin tim me këtë, që institucione tona nuk ndryshohen as me zgjedhjen e tyre në qoftë se e bëjnë menjëherë tash ose pas katër muaj dite. Në qoftë se është në pyetje interesi partiak, me siguri do parti kanë dëshirë me qenë pak më vonë, derisa bëjnë konsolidime, a në qoftë se e ngrisin veten për interesin shtetëror dhe funksionimin e institucioneve, atëherë me siguri është më mirë sa më shpejt.

Unë do ta votoj këtë mocion, por duhet theksuar edhe veprimet e papërgjegjshme të cilat na kanë sjell në këtë situatë. Kriza nuk është vetëm për shkak të veprimit ad-hoc të tërheqjes nga Qeveria, por kriza është shumë më e thellë dhe nuk është sot koha për ta bërë analizën, por Kuvendi i sotëm më shumë ka përngjarë në një gjuajtje ose luftë partiake, sesa për një seriozitet për të dalë nga kriza. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri! Ismet, shkurt, a?

ISMET BEQIRI: Po, si deputet, se edhe ashtu kam folur shumë shkurt!
Faleminderit, zoti kryetar!

Unë veç po e përsëris, po ju lus, ndoshta tash pas fjalës së profesor Hamitit... Vazhdimi i përdorimit të terminologjisë së termeve shumë patriotike dhe antipatriotike, t'i lus disa nga kolegët... Partia e LDK-së, analizat e brendshme që po na i bëjnë neve në LDK, dezertimi, ta lënë këtë terminologji sepse nuk iu duhet. LDK-ja e ka përdorur një të drejtë të veten, të bëjë marrëveshje koalicioni dhe një të drejtë legjitime, po ashtu, edhe të tërhiqet dhe sot është mocioni. Ne e kemi thënë qëndrimin tonë. Ne e dimë se ka filluar fushata, por e thatë edhe në fjalën e juaj, t'i përmbahemi vërtet mocionit dhe asaj çka është në rend të ditës dhe jo këtu, disa kolegë, që deri dje, deri sot... Ne duhet të jemi përsëri kolegë, por jo me këto terminologji e këto terma që, për mendimin tim, edhe janë fyese dhe s'i bëjnë nder asnjë deputeti që po i përmend, sepse nuk matet patriotizmi dhe tradhtia e dikujt qoftë si individ, qoftë si subjekt politik nga analizat që i bën momentale – ad-hoc, edhe të pamatura, edhe të paqëndrueshme, cilito qoftë prej nesh këtu.

Prandaj, ky është si një apel i imi. Ne e kemi qëndrimin tonë dhe Kuvendi është ai që vendos.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hajdin Abazi e ka fjalën. Rrumbullakoje, mundësisht në dy-tre minuta!

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Këtu u tha se PDK-së gjoja po i konvenuakan zgjedhjet sa më të shpejta. Në një kuptim, kjo është e vërtetë, se PDK-ja është e gatshme çdoherë t'u përgjigjet situatave dhe këtë ne e dëshmuam edhe me kongresin që e mbajtëm, ku u reflektua një unitet i pashembullt dhe që është real e substancial. Kjo dikujt po i pengon, por kjo është konkurrenca politike.

Një gjë që është me rëndësi, pse, pse dhe përsëri - pse u bashkua opozita dhe pozita për këtë mocion. Unë jam njëri nga ata që e kam nënshkruar mocionin, por kjo ka qenë krejt rastësi sepse, ende pa u shpall mocioni, unë kam shkruar një artikull dhe e kam botuar në të përditshmet ku kam thënë se kjo Qeveri, kështoj duhet sa më shpejt ta ndërpres punën e vet dhe të shkojë në zgjedhje që ta stabilizojmë vendin. Prandaj, kur ka lindur kjo iniciativë, e kam nënshkruar me kënaqësi sepse ka qenë në kuadër të opsioneve të mia. Kjo filozofi që të ndërpritet një qeverisje nga një parti dhe ne këtu jemi deputetë dhe e dimë kur një parti e ka një qeveri çfarë emri ka dhe pikërisht pse, unë nuk dëshiroj që qeverisjen ta bëjë një parti, sepse nesër do të kthehej si bumerang edhe kundër demokracisë sonë dhe pikërisht edhe kundër Partisë Demokratike, po edhe kundër institucioneve, sepse ne duam ta instalojmë edhe më mirë demokracinë dhe jo kulturën fashiste, prandaj për këtë arsye unë do ta përkrah e votoj edhe tash mocionin.

Është e vërtetë se PDK-ja ka shpreh disa herë tentativa për ta prishur koalicionin, por ka treguar mençuri dhe e ka parë se kjo e dëmton interesin e shtetit, është tërhequr dhe e ka vazhduar koalicionin. Unë kam shkruar dhe kam thënë, në interes të shtetit do të duhej edhe LDK-ja të tërhiqej dhe ta rikthejë koalicionin të paktën deri në shkurt, me qëllim që ta aprovojmë buxhetin dhe t'i pengojmë një sërë krizash potenciale që mund të rrjedhin. Për fat të keq, kjo duket që nuk do të bëhet.

Dhe, diçka tjetër. Këtu, nga disa kolegë opozitarë, sikur u prejudikua që përsëri PDK-ja do ta marrë pushtetin. Këtu jam i bindur se kanë të drejtë. Në dy zgjedhje kemi dëshmuar se kemi dal më të fortë, jo me manipulime, por nga vullneti i qytetarëve të Kosovës, nga vota e qytetarëve të Kosovës.

Dhe, duke e përfunduar, krejt në fund po them edhe një herë se zoti kryeministër Hashim Thaçi është i madh, është George Washington i Kosovës, sepse për interesin e shtetit të Kosovës po përpiqet dhe po kërkon që ta përkrahim për ta ndërpre këtë qeverisje defektoze, këtë gjysmë qeverisje që s'mund ta çojë punën deri në vend dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme janë ato që do ta stabilizojnë qeverisjen, institucionet dhe do të tregojnë se cila parti vërtet e meriton pushtetin. Do ta tregojë qytetari, do ta tregojë elektorati. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Mocioni për rrëzimin e Qeverisë, sipas mendimi tim, është një hap i panevojshëm, sepse ka pasur dhe mund të ketë zgjidhje tjera të cilat do të ishin më të mira për interesin e qytetarit të Kosovës.

Qytetarët e Kosovës nuk kanë pritur që institucionet e vendit të bëjnë eksperiment të imponuar me fatin e vendit i cili ende nuk i ka mbushur 3 vjet të qenit shtet.

Eksperimentimi me Kosovën do të vazhdojë edhe më tutje, pasi e kemi një Kushtetutë e cila është e paqartë dhe me shumë kuptime.

Fatkeqësisht, këtë Kushtetutë ne e kemi votuar vetë, por asnjëri nga deputetët nuk e ka studiuar. Eksperimenti i parë filloi nga Gjykata Kushtetuese, e cila vetë e shkeli Kushtetutën me rastin e interpretimit të Kushtetutës për presidentin.

Presidenti, Qeveria, Parlamenti kanë treguar sukses gjatë këtyre 3 vjetëve. Gjatë këtyre 3 vjetëve është bërë shpallja e pavarësisë së Kosovës, e cila ka qenë kulmi i të gjitha sukseseve. Ishte suksesi në Gjykatë Ndërkombëtare të Drejtësisë, një sukses i cili vërtet duhet t'i drejtohet Qeverisë e posaçërisht ministrit të Punëve të Jashtme, i cili edhe në seanca të Këshillit të Sigurimit të OKB-së arriti ta prezantojë Kosovën si duhet, duke e nxjerrë prej taktit edhe kryetarin e shtetit serb.

Ka pasur suksese edhe të mëtutjeshme kjo qeveri, në ngritjen e kapaciteteve, në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, andaj nuk është mirë që në këtë formë, kjo qeveri të bie.

Unë mendoj se suksesi i cili është arritur gjer më tani, qoftë nga Qeveria, qoftë nga institucionet e vendit, ishte halë në sy për disa të cilët janë kundër interesit të Kosovës dhe të cilët, fatkeqësisht, po punojnë dhe do të punojnë edhe më tutje për të bërë eksperimente me fatin e Kosovës.

Nuk është e vërtetë që LDK-ja është shkaktar i kësaj krize artificiale. Por, pikërisht veprimet eksperimentale, edhe një herë po them, të imponuara të tjerëve ndaj institucioneve të vendit e kanë prurë gjendjen në këtë situatë që jemi.

Dalja nga kjo krizë ka mund të bëhet dhe mund të bëhet edhe me zgjidhje tjera. Prandaj, unë mendoj që edhe ky mocion nga AKR-ja është i imponuar nga dikush tjetër dhe nuk duhet të mbështetet, por duhet t'i jepet forcë dhe përkrahje Qeverisë deri në zgjedhjet e 13 shkurtit, në mënyrë që Kosova vërtet të mos bëhet shtet apo vend i eksperimenteve të ndryshme. Boll jemi ngopur me eksperimente, të cilat na kanë prurë në një situatë të palakueshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është deputetja e fundit, e lajmëruar për fjalë, Sanije Aliaj dhe pastaj janë 5 minuta të sponsoruesit të mocionit.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në praktikën parlamentare koalicionet bëhen për interesa politike dhe ato nuk funksionojnë prej atij momenti kur të fillojnë të shkelen ato interesa.

Deputetë të nderuar,

Sot Kuvendi po shihet se do të votojë kundër një vendimi që ditë më parë subjektet politike me konsensus të plotë kanë arritur ta çojnë vendin në zgjedhjet e parakohshme me datën 13 shkurt.

Kuvendi sot po shihet në lëndinë se me votën e vet do ta çojë vendin në zgjedhjet e jashtëzakonshme. Vetë fjala e jashtëzakonshme nënkupton ngulfatje të demokracisë në Kosovë. Sot me votën tonë nuk po e votojmë mocionin për mosbesimin ndaj Qeverisë, sepse Qeveria në përbërje aktuale edhe më tej do të funksionojë.

Sot Kuvendi i Republikës së Kosovës, me vetëdije apo pa të, po voton për ta shpartalluar vetveten, i cili konsideroj që në mandatin e vet ka shpallur Kosovën shtet dhe ka miratuar një numër të madh ligjesh në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian, që e drejton Kosovën drejt integriteteve evropiane.

Dhe, krejt në fund, mendoj se nuk është mençuri që për interesa personale të grupeve të caktuara, ia veshim vetes etiketën jo të mirë të Kuvendit historik, se me votën e vet çon vendin drejt zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe e shpartallon vetveten. Ky votim i sotëm nuk i ndalë parregullsitë, ato edhe më tutje vazhdojnë të jetësohen.

Kjo seancë, me votën e vet i realizon dy veprime: veprimi i parë që PDK-ja voton mosbesimin ndaj Qeverisë dhe veprimi i dytë, që deputetët me votën e vet e shpartallojnë Kuvendin. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Nejse, Kuvendi nuk shpartallohet. Fjalën e ka, do të thotë, në emër të grupit dhe iniciuesit të mocionit, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, edhe një herë po shfrytëzoj rastin që t'i falënderoj të gjithë ata deputetë, pavarësisht cilave grupe politike u takojnë, që kanë mbështetur mocionin e sponsorizuar nga ne.

Më lejoni, zoti kryetar, që shkurtimisht të përgjigjem, ose t'iu jap përgjigje disa prej çështjeve që u ngritën këtu. Dua të bëj të qartë se ne nuk e kemi dëshiruar këtë gjendje. Në këtë gjendje na ka sjellë papërgjegjësia e partive politike dhe e klasës politike në udhëheqje. Dikush e tha se ka pasur alternativa të tjera, në mënyrë që të mos shkojë vendi në këtë gjendje. Po, unë i pyes, pse nuk i futët në përdorim këto alternativa? Kush ua ka ndaluar? Cilët kanë qenë ata të cilët pra nuk kanë lejuar që grupet e deputetëve, grupet parlamentare dhe partitë politike të mos ndërmarrin veprime përmes të cilave do të sanohej kjo gjendje? Ne e kemi neglizhuar krizën e shkaktuar me rastin e dorëheqjes së presidentit dhe besoj se po që se neglizhohet edhe kjo krizë e shkaktuar në qeverisje, atëherë vendi rrezikon të hyjë në kriza më të thella.

Këtu sot, për këtë mocion kam dëgjuar lloj-lloj mendimesh dhe e respektoj gjithsecilin po, megjithatë, më duhet t'i them disa fjalë.

E para, askujt nuk i është ndaluar të parqet mocion mosbesimi ndaj Qeverisë as para një muaji, as para një viti dhe as para dy vitesh. Andaj, ju që na akuzuat neve pse s'e kemi bërë më herët një veprim të tillë, po ju pyes - pse ju nuk e keni bërë një gjë të tillë, kush ua ka ndaluar? Sigurisht, sepse ju kanë rrezikuar bizneset tuaja.

E dyta, akuzat se arsyetimi i mocionit është i papranueshëm dhe i dëmshëm, dua të përgjigjem dhe njëkohësisht ju pyes - jeni apo nuk jeni për rrëzimin e kësaj qeverie? Jeni apo nuk jeni që kjo keq-qeverisje të vazhdojë edhe më tutje në vend?

E treta, akuzat se mocioni është kundërligjor dhe kundër-kushtetues sepse na u paskan shpall zgjedhjet për 13 shkurt, po ju them se zgjedhjet e 13 shkurtit janë kundërkushtetuese, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh zgjedhje në mes të mandatit. Zgjedhjet janë ose të rregullta, që mbahen jo ma larg se 60 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i mandatit, ose zgjedhje të parakohshme, që mbahen në një afat kohor më së paku 30 dhe më së largu 45 ditë. Prandaj, zgjedhjet e caktuara për 13 shkurt janë antikushtetuese.

E katërta, disa prej kolegëve na akuzuan se kemi bërë marrëveshje me PDK-në, po ju përgjigjem atyre dhe po dua t'i tregoj opinionit se nga keqqeverisja përfitojnë vetë këta që tash na sulmojnë neve, sigurisht sepse kanë tender bashkë me Qeveri. E besoj, e besoj shumë dhe prandaj nuk janë për t'u rrëzuar kjo qeveri dhe janë për t'ia zgjatur jetën kësaj qeverie.

E pesta, këtu u dëgjuan zëra për kërcënim ndaj deputetëve për nënshkrim të mocionit. Dëgjova akuza se ka pasur kërcënim ndaj deputetëve. Kolegë deputetë, gjithsecili prej jush e keni mundësinë të deklarojeni. Por, ata që po na akuzojnë për kërcënime, vetë janë njerëz që kërcënojnë dhe shantazhojnë. Madje, këtë e kanë edhe zanat politik.

Në fund, një gjë kam arritur ta kuptoj dhe po e përmbyll. Hipokrizia që ekziston te shumica e politikanëve të vendit – tjetër flasin, tjetër veprojnë. Faleminderit shumë, zotëri kryetar! Dhe, po ju ftoj edhe një herë që ta mbështesni mocionin e nënshkruar nga 40 deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, pothuaj se nga të gjitha grupimet politike. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri, zoti Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të gjithëve faleminderit shumë për debatin tuaj!

Edhe tash, pasi jemi në përmbyllje të këtij debati, tash kur jemi në prag të votimit, të theksoj edhe një herë se vota juaj është vendimi për Kosovën e nesërme, vendimi juaj është kushtetues, ligjor dhe i drejtë.

Çdo vendim i Parlamentit të Republikës së Kosovës, i njerëzve të zgjedhur nga populli, për mua është i pranueshëm dhe i respektuar. Vendimi juaj për votim paraqet strategji dalëse për institucionet e Republikës së Kosovës nga kriza, për të gjitha institucionet, duke u nisur nga Presidenca, nga Parlamenti dhe Qeveria e Kosovës.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Vota juaj paraqet fillim të ri për shtetin e Kosovës, vota juaj paraqet zhvillim dhe forcim të demokracisë në Kosovë dhe ju ftoj të gjithëve, para se të votoni mbi interesat partiake, të mendoni së pari për Kosovën. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se kemi harxhuar edhe kohën, më shumë se sa që ndoshta është dashur për shqyrtim të mocionit për mosbesim ndaj Qeverisë, të parashtruar nga Grupi Parlamentar i AKR-së, me mbështetje të 40 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pasi janë harxhuar të gjitha fjalët, unë mund të konstatoj se në sallë gjenden 104 deputetë, dhe tash i 105-ti po del, janë të gjitha kushtet për të votuar.

(Ndërhyrje)

Çështjen e kartelave!? Janë 79 kartela të vendosura. Deri tani ishin mbi 100, mirëpo kemi numër të mjaftueshëm për të votuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

(Duartrokitje)

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

A ka “për”, pa kartelë? “Kundër”, pa kartelë? Nuk ka. Faleminderit!

Mendoj se votat ishin të mjaftueshme.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve